



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 140

Tiranë – E martë, 4 gusht 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 29.7.2015	Për disa ndryshime në ligjin nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”..... 10081
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 638, datë 22.7.2015	Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 – 2016..... 10093
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 644, datë 22.7.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2015 në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar..... 10104
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 22.7.2015	Për përcaktimin e afateve dhe të procedurave të kalimit të bashkëpronësisë së detyrueshme mbi truallin e lirë, në zonat me përparësi turizmin..... 10104
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 22.7.2015	Për përcaktimin e procedurave e të kriterëve të përzgjedhjes së zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik..... 10106
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 648, datë 22.7.2015	Për miratimin e kriterëve të caktimit të menaxherit, oficerit të sigurisë e inspektorit të autorizuar dhe të metodologjisë së analizës së riskut për sigurinë e tuneleve rrugore..... 10114



AKT NORMATIV
Nr. 1, datë 29.7.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN
NR. 160/2014, “PËR BUXHETIN E VITIT
2015”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 1

Buxheti për vitin 2015 është:

Të ardhurat	398 210	milione lekë;
Shpenzimet	456 437	milione lekë;
Deficiti	58 227	milione lekë.”.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve.

Neni 2

Neni 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2015 është:

Të ardhurat	314 958	milione lekë;
Shpenzimet	373 185	milione lekë;
Deficiti	58 227	milione lekë.”.

Neni 3

Neni 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2015 është:

Të ardhurat	40 377	milione lekë;
Nga të cilat:		
Transfertë nga buxheti qendror	24 814	milione lekë;
Të ardhura të tjera	15 563	milione lekë;
Shpenzimet	40 377	milione lekë.”.

Neni 4

Neni 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2015 është:

1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror		
Të ardhurat, gjithsej	100 940	milione lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet	59 118	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	35 822	milione lekë;
- përdorimi i gjendjes nga viti 2014	6 000	milione lekë
Shpenzimet	100 940	milione lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshon sa herë që rriten pagat dhe pensionet. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar duke mbuluar nga buxheti i shtetit diferencën midis këtyre kontributeve me masën e kontributit të përcaktuar për personat e vetëpunësuar në qytet. Për vitin 2015, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve sipas degëve të sigurimit shoqëror dhe programeve të tjera të veçanta e suplementare të përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej	5 508	milione lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet	770	milione lekë;
-transferimet nga buxheti i shtetit	4 738	milione lekë;
Shpenzimet	5 508	milione lekë.

Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 034 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.”.

Neni 5

Neni 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:



“Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2015 është:

Të ardhurat, gjithsej	34 814	milione lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet dhe të tjera	9 201	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	25 613	milione lekë;
Shpenzimet	34 814	milione lekë.

Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Neni 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2015 është:

Të ardhurat, gjithsej	2 000	milione lekë;
Nga të cilat:		
- të ardhura të tjera	1 600	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	400	milione lekë;
Shpenzimet	2 000	milione lekë.”.

Neni 7

Neni 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 8

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	12 000	milione lekë;
Të ardhurat tatimore	272 358	milione lekë;
Të ardhurat jotatimore	30 600	milione lekë.”.

Neni 8

Neni 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 9

Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 58 227 milionë lekë. Në rast mosrealizimi të të ardhurave të buxhetit dhe të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja totale për financimin e deficitit prej 51 727 milionë lekësh nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Të ardhurat nga privatizimi që mund të krijohen gjatë vitit 2015 mbi shumën e vendosur në këtë ligj përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila, automatikisht, rrit kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2, të këtij ligji.”.

Neni 9

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

1. Nënndarjet: “Shpenzime të buxhetit qendror”, “Fondi rezervë dhe kontingjenca”, “Detyrimet e prapambetura” dhe “Huadhënie për energjinë” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Shpenzime të buxhetit qendror	347 233	milione lekë;
Fondi rezervë dhe kontingjenca	4	milione lekë;
Detyrimet e prapambetura	952	milione lekë;
Huadhënie për energjinë	20 000	milione lekë;
	1 000	milione lekë.”.

2. Tabela 1, që përmendet në këtë nen, zëvendësohet me tabelën 1 që i bashkëlidhet këtij akti normativ”.

Neni 10

Në nenin 11 numri i punonjësve bëhet 88 600 veta, ndërsa fondi i veçantë bëhet 340 milionë lekë.

Neni 11

Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 13

Fondi rezervë i buxhetit prej 1 552 milionë lekësh përdoret nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore. Fondi i kontingjencës prej 3 400 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave:

- Deri në masën 2 000 milionë lekë për të përballuar nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve ekzistuese.
- 1 400 milionë lekë për ekzekutimin e pagesave për detyrime ndërkombëtare.”.



Neni 12

Neni 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 15

Transfertat e pakushtëzuara që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Transfertat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet njësive të pushtetit vendor, sipas formulës së paraqitur në aneksin 1, me ndryshimin bashkëlidhur. Shuma e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë paraqitet në tabelën 3, të ndryshuar, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondi i kompensimit nga totali i transfertës së pakushtëzuar përdoret nga Ministria e Financave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 2, të ndryshuar, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondi për zhvillimin e rajoneve shpërndahet sipas aneksit 3, të ndryshuar, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondet për konviktet e arsimit parauniversitar shpërndahen sipas aneksit 4, të ndryshuar, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondet për administrimin e qendrave të shërbimit social shpërndahen sipas aneksit 5, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Transferta e pakushtëzuar për bashkitë do të ndahet në muaj dhe tremujorë. Për rastet e nevojshme për zbatimin e reformës territoriale, Këshilli i Ministrave nxjerr aktet e nevojshme.

Bashkitë, që kanë deri në 20 000 banorë, përdorin deri në 40 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Bashkitë, që kanë 20 001 - 50 000 banorë, përdorin deri në 30 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Bashkitë, që kanë mbi 50 001 banorë, përdorin deri në 10 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Këshillat e qarqeve përdorin deri në 15 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ. Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore për ndërmarrjet e rrugëve të këshillave të qarqeve duhet të jenë deri

në 40 për qind të buxhetit vjetor të këtyre ndërmarrjeve.

Kur shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve dhe njësitë e qeverisjes vendore për sistemin e pompimit rezultojnë debitore për furnizimin me energji elektrike ndaj kompanisë së shpërndarjes, deri në fund të tremujorit të tretë, transfertat e pakushtëzuar e njësive të qeverisjes vendore e tremujorit të katërt bllokohet dhe përdoret për shlyerjen e këtyre detyrimeve.

Fondet që, sipas këtij neni, u vihen në dispozicion njësive të qeverisjes vendore, fondet e tjera që, me akte të tjera ligjore dhe nënligjore, u kalojnë njësive të qeverisjes vendore, si dhe me vendimet e këshillave komunalë, bashkiakë dhe të këshillave të qarqeve, që kanë lidhje me përdorimin e fondeve buxhetore, bëhen publike.”

Neni 13

Neni 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 18

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2015, është 80 328 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

1. Për huamarrjen vjetore neto për mbështetjen buxhetore nga burime të brendshme dhe të huaja deri në 55 644 milionë lekë.

2. Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja deri në 9 084 milionë lekë.

3. Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 15 600 milionë lekë.

Stoku i borxhit shtetëror (pa përfshirë detyrimet e prapambetura) vlerësohet të arrijë deri në 987 291 milionë lekë.

Stoku i borxhit të garantuar vlerësohet të arrijë 70 140 milionë lekë.”

Neni 14

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYE MINISTRI

Edi Rama



AKTI NORMATIV 2015 - SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Tab 1

Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i Brendshëm	Financimi Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
1	Presidenca	175,500	11,000	0	11,000	186,500
01120	Veprimtaria e Presidentit	175,500	11,000	0	11,000	186,500
2	Kuvendi	1,006,400	67,220	0	67,220	1,073,620
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	328,500	67,220	0	67,220	395,720
01120	Veprimtaria ligjvënëse	677,900	0	0	0	677,900
3	Kryeministria	515,125	100,000	100,000	200,000	715,125
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	515,125	100,000	100,000	200,000	715,125
4	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	926,876	272,006	750,000	1,022,006	1,948,882
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	264,000	48,358	90,000	138,358	402,358
04130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	252,000	159,355	650,000	809,355	1,061,355
04160	Mbështetje për Mbikq. e Tregut, Infrast. e Çiles. dhe Pron. Industr.	231,900	50,193	10,000	60,193	292,093
04760	Zhvillimi i Turizmit	178,976	14,100	0	14,100	193,076
5	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	5,113,043	1,348,117	2,051,364	3,399,481	8,512,524
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	243,000	15,000	0	15,000	258,000
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,381,610	140,110	161,353	301,463	1,683,073
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	974,850	955,000	560,000	1,515,000	2,489,850
04250	Zhvillimi Rural duke mbësht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.	2,067,150	111,353	1,158,626	1,269,979	3,337,129
04860	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	226,900	48,000	0	48,000	274,900
05470	Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore	22,000	4,000	0	4,000	26,000
04230	Mbështetje për Peshkimin	88,300	28,000	86,000	114,000	202,300
05640	Administrimi i Ujërave	109,233	46,654	85,385	132,039	241,272
6	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	2,765,095	17,382,058	15,207,028	32,589,086	35,354,181
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	378,000	20,000	110,000	130,000	508,000
04520	Transporti rrugor	1,322,500	13,021,058	5,672,756	18,693,814	20,016,314
04530	Mbështetje për studime në transport	19,430	1,000	0	1,000	20,430
04540	Transporti Detar	74,565	330,000	250,000	580,000	654,565
04550	Transporti Hekurudhor	459,300	150,000	175,000	325,000	784,300
04560	Transporti Ajror	23,000	5,000	0	5,000	28,000
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	488,300	3,755,000	8,699,272	12,454,272	12,942,572
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	0	100,000	300,000	400,000	400,000
10	Ministria e Financave	6,647,281	418,042	482,904	900,946	7,548,227
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	294,020	149,000	37,800	186,800	480,820
01120	Menaxhimi i shpenzimeve publike	511,981	10,000	0	10,000	521,981
01130	Ekzekutimi i pagesave te ndryshme	1,410,150	0	0	0	1,410,150
01140	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	2,217,000	86,800	0	86,800	2,303,800
01150	Menaxhimi i të ardhurave doganore	2,130,800	158,242	445,104	603,346	2,734,146
01160	Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore	83,330	14,000	0	14,000	97,330
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	37,570,480	2,460,500	300,000	2,760,500	40,330,980
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	698,230	92,500	0	92,500	790,730
09120	Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin)	23,532,920	1,354,708	0	1,354,708	24,887,628
09230	Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)	6,141,971	437,292	200,000	637,292	6,779,263
09450	Arsimi universitar	5,345,590	348,000	100,000	448,000	5,793,590
09770	Fonde për Shkencën	177,000	0	0	0	177,000
08140	Zhvillimi i Sportit	1,674,769	228,000	0	228,000	1,902,769
12	Ministria e Kulturës	1,267,160	289,203	20,000	309,203	1,576,363
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	127,966	40,000	0	40,000	167,966
08220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	400,146	143,203	20,000	163,203	563,349
08230	Arti dhe Kultura	739,048	106,000	0	106,000	845,048
13	Ministria e Shëndetësisë	29,940,900	1,490,526	930,000	2,420,526	32,361,426
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	224,000	13,210	0	13,210	237,210
07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	8,932,000	229,423	136,480	365,903	9,297,903
07330	Shërbimet e Kujdesit Dytësor	17,905,236	1,116,893	793,520	1,910,413	19,815,649
07450	Shërbimet e Shëndetit Publik	2,686,900	41,000	0	41,000	2,727,900
07460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	192,764	90,000	0	90,000	282,764
14	Ministria e Drejtësisë	5,695,100	909,000	500,000	1,409,000	7,104,100
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	352,060	877,130	500,000	1,377,130	1,729,190
01120	Publikimet Zyrtare	56,185	200	0	200	56,385
01130	Mjekësia Ligjore	50,500	12,000	0	12,000	62,500
03440	Sistemi i Burgjeve	4,383,136	18,000	0	18,000	4,401,136
03350	Shërbimi i Përbarimit Gjyqësor	103,800	1,000	0	1,000	104,800
01160	Shërbimet për Çështjet e Birësimeve	13,002	200	0	200	13,202
01180	Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	580,247	470	0	470	580,717
03490	Shërbimi i Provës	156,170	0	0	0	156,170
15	Ministria e Punëve të Jashtme	2,226,000	110,000	0	110,000	2,336,000



Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i Brendshëm	Financimi Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	95,500	101,000	0	101,000	196,500
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	1,932,000	9,000	0	9,000	1,941,000
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	198,500	0	0	0	198,500
16	Ministria e Brendshme	18,273,449	1,322,000	305,750	1,627,750	19,901,199
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,009,310	240,000	0	240,000	1,249,310
03140	Policia e Shtetit	13,801,499	653,000	305,750	958,750	14,760,249
03150	Garda e Republikës	1,238,000	50,000	0	50,000	1,288,000
01160	Prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor	535,640	10,000	0	10,000	545,640
01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	806,000	359,000	0	359,000	1,165,000
01180	Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	104,000	10,000	0	10,000	114,000
10910	Emergjencat Civile	779,000	0	0	0	779,000
17	Ministria e Mbrojtjes	10,951,140	1,720,000	0	1,720,000	12,671,140
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,166,000	79,800	0	79,800	1,245,800
02120	Forcat e Luftimit	4,347,335	1,496,200	0	1,496,200	5,843,535
09430	Arsimi Ushtarak	642,100	0	0	0	642,100
02150	Mbështetja e Luftimit	4,795,705	144,000	0	144,000	4,939,705
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	1,386,000	50,000	0	50,000	1,436,000
03520	Veprimtaria Informative Shtetërore	1,386,000	50,000	0	50,000	1,436,000
19	Drejtoria e Radio Televizionit	357,000	0	0	0	357,000
08310	Shërbimet për shqiptaret jashtë kufirit	240,000	0	0	0	240,000
08520	Projekte teknike për futjen e teknologjive te reja	0	0	0	0	0
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare	62,000	0	0	0	62,000
08340	Orkestra Simfonike e RTSH dhe Kinematografisë	55,000	0	0	0	55,000
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	158,700	5,000	0	5,000	163,700
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	158,700	5,000	0	5,000	163,700
22	Akademia e Shkencës	91,300	2,900	0	2,900	94,200
01520	Veprimtaria Akademike	91,300	2,900	0	2,900	94,200
24	Kontrolli Lartë i Shtetit	330,000	20,000	30,000	50,000	380,000
01120	Veprimtaria audituese e KLSH-së	330,000	20,000	30,000	50,000	380,000
25	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinise	68,780,570	447,195	243,000	690,195	69,470,765
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	146,100	41,250	0	41,250	187,350
10220	Sigurimi Shoqëror	40,560,000	0	0	0	40,560,000
10430	Përkujdesja Sociale	22,491,500	45,217	100,000	145,217	22,636,717
10550	Tregu i Punës	1,812,000	60,011	0	60,011	1,872,011
04170	Inspektimi në Punë	169,500	30,124	0	30,124	199,624
10460	Përfshirja Sociale	53,500	44,454	0	44,454	97,954
08480	Mbështetje për Kultet Fetare	218,400	141	0	141	218,541
01190	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë	2,032,000	4,300	0	4,300	2,036,300
09240	Arsimi i mesëm (profesional)	1,297,570	221,698	143,000	364,698	1,662,268
26	Ministria e Mjedisit	1,143,267	870,339	364,615	1,234,954	2,378,221
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	178,764	18,000	0	18,000	196,764
05320	Programe për Mbrojtjen e Mjedisit	433,596	636,461	314,615	951,076	1,384,672
04260	Administrimi i Pyjeve	530,907	215,878	50,000	265,878	796,785
28	Prokuroria e Përgjithshme	1,453,375	175,000	60,000	235,000	1,688,375
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,453,375	175,000	60,000	235,000	1,688,375
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqësor	1,946,500	210,000	0	210,000	2,156,500
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	26,000	400	0	400	26,400
03310	Buxheti gjyqësor	1,920,500	209,600	0	209,600	2,130,100
30	Gjykata Kushtetuese	108,100	12,000	0	12,000	120,100
03320	Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese	108,100	12,000	0	12,000	120,100
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	63,200	1,000	0	1,000	64,200
08320	Veprimtaria Telegrafike e ATSH-së	63,200	1,000	0	1,000	64,200
40	Partitë Politike	200,000	0	0	0	200,000
01110	Mbështetje për Partitë Politike	190,000	0	0	0	190,000
01120	Mbështetje për Shoqatat	8,000	0	0	0	8,000
01130	Mbështetje për Organizatat e Vetëneve me Status	2,000	0	0	0	2,000
50	Instituti Statistikës	418,230	23,192	0	23,192	441,422
01320	Veprimtaria Statistikore	418,230	23,192	0	23,192	441,422
55	Shkolla e Magjistraturës	57,000	3,500	0	3,500	60,500
09820	Veprimtaria arsimore	57,000	3,500	0	3,500	60,500
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	1,400,000	5,650,000	7,050,000	7,050,000
06210	Programe zhvillimi	0	1,400,000	5,650,000	7,050,000	7,050,000
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	140,270	2,360	0	2,360	142,630
08220	Mbështetja e veprimtarisë kinematografike	140,270	2,360	0	2,360	142,630
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	88,560	2,000	0	2,000	90,560
03320	Veprimtaria mbikëqyrëse e KLD-së	88,560	2,000	0	2,000	90,560
66	Avokati i Popullit	91,500	4,000	0	4,000	95,500
03320	Shërbimi i Avokatisë	91,500	4,000	0	4,000	95,500



Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i Brendshëm	Financimi Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	46,470	7,000	0	7,000	53,470
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	46,470	7,000	0	7,000	53,470
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	684,800	8,000	0	8,000	692,800
01610	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	84,800	8,000	0	8,000	92,800
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	600,000	0	0	0	600,000
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	105,520	16,280	0	16,280	121,800
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	105,520	16,280	0	16,280	121,800
77	Autoriteti i Konkurrencës	62,840	1,000	0	1,000	63,840
04120	Mbikëqyrja e tregut & garantimi i konkurrencës	62,840	1,000	0	1,000	63,840
78	Ministria e Integritimit	167,900	80,372	310,000	390,372	558,272
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	55,700	35,372	0	35,372	91,072
01140	Drejtesia dhe tregu i brendshëm	30,000	0	0	0	30,000
01150	Mbështetja Institucionale për Procesin e Integritimit	82,200	45,000	310,000	355,000	437,200
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	12,500	1,000	0	1,000	13,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	12,500	1,000	0	1,000	13,500
87	Institucione te tjera Qeveritare	1,378,054	576,200	100,000	676,200	2,054,254
01320	Shërbime Qeveritare	90,000	16,500	0	16,500	106,500
01130	Shërbimi i Prokurimit Publik	76,000	7,000	0	7,000	83,000
01140	Shërbime për Shoqërinë e Informacionit	877,836	429,700	0	429,700	1,307,536
01150	Shërbime te tjera	116,373	41,000	0	41,000	157,373
01510	Shërbime për Teknologjinë dhe Inovacionin	22,900	77,000	0	77,000	99,900
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike	137,025	5,000	0	5,000	142,025
01160	Shqipëria Dixhitale	57,920	0	100,000	100,000	157,920
88	Mbështetje për Shoqërinë Civile	119,500	1,000	0	1,000	120,500
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	119,500	1,000	0	1,000	120,500
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	57,000	15,500	0	15,500	72,500
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	57,000	15,500	0	15,500	72,500
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	36,500	1,000	0	1,000	37,500
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	36,500	1,000	0	1,000	37,500
92	Instituti i Studimeve te Krimeve te Komunizmit	31,000	1,000	0	1,000	32,000
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	31,000	1,000	0	1,000	32,000
93	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	626,230	1,646,381	303,000	1,949,381	2,575,611
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	207,990	1,175,481	33,613	1,209,094	1,417,084
04320	Mbështetje për Energjinë	12,000	137,075	236,387	373,462	385,462
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	166,200	252,025	33,000	285,025	451,225
04440	Mbështetje për mbikëqyrjen e standardeve teknike te hidrokarbureve dhe minierave	240,040	81,800	0	81,800	321,840
94	Ministria e Zhvillimit Urban	1,119,404	719,467	374,000	1,093,467	2,212,871
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	192,976	60,000	0	60,000	252,976
06180	Planifikimi Urban dhe Strehimi	926,428	659,467	374,000	1,033,467	1,959,895
TOTALI		204,334,839	34,202,358	28,081,661	62,284,019	266,618,858

ANEKS 1

FORMULA E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR - KRITERET DHE KOEFICIENTËT

Kriteri	Koeficienti	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
8. Fondi për Zbatimin e Reformës së Administrativo-Territoriale			
Ky fond krijohet duke u zbritur 50% nga granti i përgjithshëm njësisë të qeverisjes vendore që me ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative - territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" do të suprimohen.		2,738,983	Ky fond do të akomodohet sa vijon: - Shuma prej 681,300 mijë lekë t'u shpërndahet 61 bashkive që do jenë pas ndarjes së re territoriale. Buxheti i vitit 2015 për këto bashki do rritet 5% në krahasim me buxhetin e vitit 2014. - Shuma prej 1,857,683 mijë lekë të jetë fond transitor për zbatimin e reformës së re territoriale. Ky fond do të përdoret për shpenzime për investime dhe të tjera. Fondi do t'u akordohet njësisë të qeverisjes vendore me vendim të Këshillit të Ministrave. Shuma prej 200,000 mijë lekë i kalon Ministrisë së Zhvillimit Urban për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2016 për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për 26 bashki të vendit.



Tab.2

Kod min	Emërtimi i Ministrisë/institucionit buxhetor	Numri punonjësve akti normativ 2015
1	Presidenca	76
2	Kuvendi	396
3	Kryeministria	242
4	Ministria Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	520
5	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	2,269
6	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	410
10	Ministria e Financave	3,107
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	38,285
12	Ministria e Kulturës	1,013
13	Ministria e Shëndetësisë	3,463
14	Ministria e Drejtësisë	4,815
15	Ministria e Punëve të Jashtme	506
16	Ministria e Brendshme	14,927
17	Ministria e Mbrojtjes	8,988
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	913
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	139
22	Akademia e Shkencës	29
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	171
25	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	2,832
26	Ministria e Mjedisit	1,131
28	Prokuroria e Përgjithshme	848
29	Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	1,339
30	Gjykata Kushtetuese	54
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	40
50	Instituti Statistikës	216
55	Shkolla e Magistraturës	24
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	9
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	50
66	Avokati i Popullit	51
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	31
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	55
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	60
77	Autoriteti i Konkurrencës	37
78	Ministria e Integritetit	104
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
87	Institucione të tjera Qeveritare	437
	<i>Agjencia Kombëtare Shqiptare e Informacionit</i>	101
	<i>Agjencia Kombëtare e Certifikimit Elektronik</i>	9
	<i>Drejtoria Sigurimit të Informacionit Klasifikuar</i>	30
	<i>Agjencia e Prokurimit Publik</i>	28
	<i>Komiteti Shtetëror i Minoriteteve</i>	8
	<i>Agjencia Kombëtare e Teknologjisë dhe Inovacionit</i>	15
	<i>Komisioni i Prokurimit Publik</i>	20
	<i>Inspektorati Qendror</i>	15
	<i>Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike</i>	6
	<i>Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)</i>	29
	<i>Departamenti i Administratës Publike</i>	43
	<i>Sekretariati I Ujit</i>	23
	<i>Shkolla e Administratës Publike</i>	17
	<i>ADISA</i>	81
	<i>Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale</i>	12
88	Mbështetje për shoqërinë civile	13
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	35
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	23
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	15
93	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	415
94	Ministria e Zhvillimit Urban	491
	Nën-Totali	88,585
	<i>Rezervë për institucione</i>	<i>15</i>
	TOTALI	88,600



**TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR PËR BASHKITË SIPAS
NDARJES SË RE ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE 2015**

Nr	Qarku	Njësiti e qeverisjes vendore	Bashki (B)	Transferta e pakushtëzuar
1	Berat	Berat	B	251,160
2		Ura Vajgurore	B	58,328
3		Kuçovë	B	108,800
4		Skrapar	B	89,928
5		Poliçan	B	55,092
6	Dibër	Dibër	B	200,915
7		Bulqizë	B	118,538
8		Mat	B	125,752
9		Klos	B	71,358
10	Durrës	Durrës	B	564,349
11		Shijak	B	64,568
12		Krujë	B	122,835
13	Elbasan	Elbasan	B	497,402
14		Cërrik	B	78,621
15		Belsh	B	68,153
16		Peqin	B	65,528
17		Gramsh	B	106,848
18		Librazhd	B	85,124
19		Prrenjas	B	62,399
20	Fier	Fier	B	342,936
21		Patos	B	100,103
22		Roskovec	B	46,777
23		Lushnjë	B	213,093
24		Divjakë	B	104,154
25		Mallakastër	B	85,878
26	Gjirokastrë	Gjirokastrë	B	149,283
27		Libohovë	B	26,936
28		Tepelenë	B	55,781
29		Memaliaj	B	54,311
30		Përmet	B	69,210
31		Këlcyrë	B	31,854
32		Dropull	B	36,493
33	Korçë	Korçë	B	308,996
34		Maliq	B	98,134
35		Pustec	B	25,365
36		Kolonjë	B	74,324
37		Devoll	B	81,462
38		Pogradec	B	176,458
39	Kukës	Kukës	B	208,137
40		Has	B	71,298
41		Tropojë	B	94,660
42	Lezhë	Lezhë	B	162,454
43		Mirditë	B	130,078
44		Kurbini	B	147,102
45	Shkodër	Malësi e Madhe	B	100,257
46		Shkodër	B	533,290
47		Vau -Dejës	B	92,633
48		Pukë	B	67,719
49		Fushë-Arrëz	B	46,541
50	Tiranë	Tiranë	B	1,387,888



51		Kamëz	B	286,231
52		Vorë	B	62,606
53		Kavajë	B	131,757
54		Rrogozhinë	B	60,868
55	Vlorë	Vlorë	B	416,881
56		Selenicë	B	65,352
57		Himarë	B	59,454
58		Sarandë	B	121,915
59		Konispol	B	28,342
60		Finiq	B	57,960
61		Delvinë	B	45,737
Fondi për Zhvillimin e Rajoneve				12,479,000
Fondi për Zbatimin e Reformës së re Administrativo-Territoriale				1,857,683
Totali				23,593,089

ANEKS 2

Kriteret e shpërndarjes së fondit të kompensimit

Nivelet e pushtetit vendor	Kriteret
A. Fonde vetëm për bashkitë	<ul style="list-style-type: none"> Kompensimi për ripërshtatjen e kapacitetit fiskal, te biznesit të vogël të pa kompensuar, apo tregues të tjerë jo të saktë në përlllogaritjet e formulës. Për nevoja të ndryshme financiare të bashkive. Për konviktet e transferuar në nivel vendor.
B. Fonde vetëm për qarqet	<ul style="list-style-type: none"> Për shpenzime të ndryshme që mund të nevojiten gjatë vitit.

Shuma që akordohet nga fondi i kompensimit për njësitë e qeverisjes vendore nuk duhet të kalojë 70 për qind të nivelit të transfertës së pakushtëzuar të akorduar me ligjin e buxhetit të vitit 2015.

Pjesa e papërdorur e fondit të kompensimit në vitin buxhetor 2015, kalon në transfertën e pakushtëzuar të vitit 2016.

Procedurat për alokimin e këtij fondi përcaktohen në udhëzimin nr. 2, datë 6.0.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe në udhëzimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2014.

ANEKS 3

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve

1. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një instrument zhvillimor që nxit dhe mbështet financiarisht programet dhe projektet zhvillimore vendore dhe rajonale.

2. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga këto shtylla:

I. Shtylla I: Programet e zhvillimit vendor dhe rajonal:

a) Granti konkurrues për infrastrukturën vendore dhe rajonale;

b) Grantet konkurruese për arsimin:

I. Granti për arsimin bazë;

II. Granti për arsimin e mesëm;

III. Granti për arsimin universitar;

IV. Granti për sportin.

c) Granti konkurrues për shëndetësinë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor);

d) Granti konkurrues për artin dhe kulturën;

e) Granti konkurrues për ujësjellës-kanalizime;

f) Granti konkurrues për vaditje dhe kullim;

g) Granti konkurrues për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzimin;

Shtylla I, Programet e zhvillimit vendor dhe rajonal detajohen në aneksin 3/1, këtu bashkëlidhur.

II. Shtylla II: Programi “Shqipëria Dixhitale” (inovacioni dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit):

a) Granti konkurrues për “Shqipëria Dixhitale”.

Shtylla II, programi “Shqipëria Dixhitale”, detajohet në aneksin 3/2, këtu bashkëlidhur.

3. Me qëllim përmbushjen e objektivave të zhvillimit rajonal, përveç projekteve vendore (programet e zhvillimit vendor dhe rajonal) dhe



qendrore/vendore (programi “Shqipëria Dixhitale”), Fondi për Zhvillimin e Rajoneve mbështet edhe projekte rajonale me bazë në “partneritetin ndërvendor” dhe “partneritetin rajonal”, me të cilat kuptohen:

a) partneriteti për projekte të bashkëpunimit ndër-bashkiak midis vetë njësisive të qeverisjes vendore, sipas ligjit;

b) dhe partneritetet rajonale:

b.1 si ato midis njësisive të qeverisjes vendore, njësisive të qeverisjes qendrore (për projekte me shumë përfitues) dhe agjencive të zhvillimit, organizatave jo fitimprurëse për zhvillim publike dhe/ose private (me bashkëkontribut),

b.2 dhe/ose partneritetet në formën e një subjekti juridik privat për investime në infrastrukturën vendore dhe rajonale me kthim (me qëllime fitimi),

Kuptimi dhe përcaktimi më i detajuar për “partneritetin rajonal”, jepet në aktet nënligjore dhe/ose programet operacionale, për çdo shtyllë të Fondit, të cilat miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

4. Shpërndarja e financimit dhe menaxhimi i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, kryhet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, me anëtarë si më poshtë vijon:

1.	Kryeministri	Kryetar
2.	Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar
3.	Ministri i Financave	anëtar
4.	Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
5.	Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	anëtar
6.	Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar
7.	Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar
8.	Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar
9.	Ministri i Shëndetësisë	anëtar
10.	Ministri i Kulturës	anëtar
11.	Ministri i Mjedisit	anëtar
12.	Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar
13.	Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar
14.	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar
15.	Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar
16.	Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar
17.	Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar

5. Në mungesë të kryetarit të Komitetit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve mbledhet si rregull minimalisht një herë në dy muaj, me kërkesë të

kryetarit.

6. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve miraton, në kuadër të shpërndarjes së financimit dhe menaxhimit të Fondit, sipas shtyllave më sipër:

a) shpërndarjen e financimit total sipas drejtimeve prioritare të investimeve, që përbëjnë nënprogramet e programeve të shtyllave I dhe II, si në pikën 2 më sipër, përpara miratimit në Këshillin e Ministrave të projektbuxhetit për vitin pasardhës, sipas propozimit të sekretariatit të përgjithshëm;

b) dokumente strategjike lidhur me objektivat zhvillimor të çdo programi, si dhe programimin e drejtimeve prioritare sipas nën programeve;

c) Programet operacionale për zbatimin e Fondit sipas programeve të shtyllave I dhe II;

d) specifikimet, formatet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve dhe ndarjen e granteve, sipas propozimit të sekretariatit të përgjithshëm, bazuar në propozimet e sekretariateve teknike;

e) përzgjedhjen paraprake të ideve dhe projektet për financim, duke përfshirë shpërndarjen e fondeve për financim për projekte të reja investimi, masën e financimit për projektet në vazhdim, si dhe nivelin e bashkëfinancimit/bashkëkontributit/bashkëpjesëm arrjes nga aplikuesit dhe/ose partneritetet rajonale;

f) rregulla të hollësishme lidhur me aplikimin, vlerësimin, menaxhimin e performancës së fondeve, si dhe sistemet e raportimit e monitorimit (manuale, formate, kriteret e vlerësimit të projekteve, formatet e hartimit të programeve operacionale);

g) procese të tjera, që ndiqen në zbatim të pikave të këtij aneksi, për administrimin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, performancën dhe arritjen e objektivave të programeve sipas shtyllave I dhe II.

7. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është pranë Kryeministrisë, si pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj.

ANEKS 3/1

Shtylla I: Programet e zhvillimit rajonal dhe vendor

1. Financimi i programeve

I. Shtylla I: Programet e zhvillimit vendor dhe rajonal:

a) Granti konkurrues për infrastrukturën vendore dhe rajonale, ka burim financimi zërin



“Shpenzimet për buxhetin vendor: Fondi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore”.

b) Grantet konkurruese për arsimin, kanë burim financimi programet e mëposhtme buxhetore të Ministrisë së Arsimit:

c) Granti për arsimin bazë, me burim financimi programin e buxhetit “Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin)”;

i) Granti për arsimin e mesëm, me burim financimi programin e buxhetit “Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)”;

ii) Granti për arsimin universitar, me burim financimi programin e buxhetit “Arsimi universitar”;

iii) Granti për sportin, me burim financimi programin e buxhetit “Mbështetje për sportin”.

d) Granti konkurrues për shëndetësinë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor), ka burim financimi programin e buxhetit “Shërbimet e kujdesit parësor” të Ministrisë së Shëndetësisë;

e) Granti konkurrues për artin dhe kulturën, ka burim financimi programin e buxhetit “Arti dhe kultura” të Ministrisë së Kulturës;

f) Granti konkurrues për ujësjellës-kanalizime, ka burim financimi programin e buxhetit “Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime” të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe ¹grantin konkurrues për infrastrukturën vendore dhe rajonale;

g) Granti konkurrues për vaditjen dhe kullimin, ka burim financimi programin e buxhetit “Mbështetje për infrastrukturë e vaditjes dhe të kullimit” të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, si dhe ²grantin konkurrues për infrastrukturën vendore dhe rajonale;

h) Granti konkurrues për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim; ka burim financimi programin e buxhetit “Administrimi i pyjeve” të Ministrisë së Mjedisit.

2. Subjektet aplikuese dhe zbatuese, përfituese të programit të shtyllës I

a) Aplikimi për fonde të Shtyllës I, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, partneritetet ndërvendore dhe rajonale, agjencitë dhe organizatat publike të zhvillimit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, shoqëritë aksionare të ujësjellësve kanalizimeve dhe

kullimit dhe universitetet. Autoriteti kontraktues caktohet me vendim të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve.

b) Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve mund të financojë projekte/pjesëmarrje nën skemat e partneritetit rajonal në formën e një subjekti juridik privat për investime në infrastrukturën vendore dhe rajonale me kthim (me qëllime fitimi). Në këtë rast, rregulla më të hollësishme për skemat e financimin e projekteve me bazë partneriteti rajonal, në formën e një subjekti juridik privat për investime në infrastrukturën vendore dhe rajonale, me kthim (me qëllime fitimi), përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe zbatohen nga Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

c) Në rastet e projekteve me disa përfitues nën skemat e partneritetit ndërvendor dhe rajonal, ose në raste të tjera të veçanta, Komiteti cakton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit, i cili mund të jetë njëri prej përfituesve dhe/ose një agjenci zhvillimore dhe organizatë jofitimprurëse publike, ose subjekti i partneritetit ndër vendor dhe rajonal.

d) Zbatimi i projekteve të miratuara me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është përgjegjësi parësore e autoriteteve kontraktuese, në bashkëpunim me përfituesit përkatës për çdo projekt, të cilat zbatojnë projektet me përpikmëri, sipas rregullave dhe akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse.

e) Rregulla të hollësishme lidhura me raportimin e autoriteteve kontraktuese, miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

3. Sekretariatet teknike

a) Sekretariatet teknike të programeve të shtyllës I ngrihen në ministritë përkatëse të linjës, si më poshtë vijon:

i) Sekretariati teknik për grantin konkurrues për infrastrukturën vendore dhe rajonale, ngrihet pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit;

ii) Sekretariati teknik për grantet konkurruese për arsimin ngrihet, pranë Ministrisë së Arsimit;

iii) Sekretariati teknik për grantin konkurrues për shëndetësinë ngrihet, pranë Ministrisë së Shëndetësisë;

iv) Sekretariati teknik për grantin konkurrues për artin dhe kulturën, ngrihet pranë Ministrisë së Kulturës;

¹ Për pikën 1/I /f më sipër, vetëm për financimin e prioritetit të ujit.

² Për pikën 1/I /g më sipër, vetëm për financimin e prioritetit të ujit.



v) Sekretariati teknik për grantin konkurrues për ujësjellës-kanalizime, ngrihet pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës;

vi) Sekretariati teknik për grantin konkurrues për vaditjen dhe kullimin, ngrihet pranë Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;

vii) Sekretariati teknik për grantin konkurrues për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim, ngrihet pranë Ministrisë së Mjedisit.

b) Rregulla të hollësishme mbi ngritjen, detyrat dhe funksionimin e sekretariatit teknik, si edhe rolin e institucioneve të tjera, në procesin e programimit, financimit, zbatimit dhe monitorimit të fondeve dhe projekteve, sipas Programeve të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

ANEKS 3/2

Shtylla II: Programi “Shqipëria Dixhitale”

1. Financimi i programit

Fondi për programin Shqipëria Dixhitale përbëhet nga granti konkurrues për inovacionin dhe teknologjinë e komunikimit, me burim financimi Fondin e Zhvillimit të Rajoneve.

2. Subjektet aplikuese dhe zbatuese, përfituese të programit të shtyllës II

a) Aplikimi për fonde të Shtyllës II bëhet nga njësitë e qeverisjes qendrore, vendore e partneritetet rajonale, si edhe institucionet dhe organizatat për zhvillim, agjencitë zbatuese e zhvillimore qendrore e vendore. Autoriteti kontraktues caktohet me vendim të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve.

b) Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve mund të vendosë financimin e skemave të Grantit për Inovacionin, nga Programi “Shqipëria Dixhitale”, me përfitues individë dhe subjekte private. Në këtë rast, rregulla më të hollësishme për skemat e Grantit për Inovacionin përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe zbatohen nga Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

c) Në rastet e projekteve me disa përfitues, ose në raste të tjera të veçanta, Komiteti cakton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit, i cili mund të jetë Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe/ose njëri prej përfituesve.

d) Zbatimi i projekteve të miratuara me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është

përgjegjësi parësore e autoriteteve kontraktuese, në bashkëpunim me përfituesit përkatës për çdo projekt, të cilat zbatojnë projektet me përpikmëri, sipas rregullave dhe akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse.

e) Rregulla të hollësishme lidhura me raportimin e autoriteteve kontraktuese, miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

3. Sekretariati Teknik

a) Sekretariati teknik për grantin konkurrues për programin “Shqipëria Dixhitale”, ngrihet pranë Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

b) Rregulla të hollësishme mbi ngritjen, detyrat dhe funksionimin e sekretariatit teknik, si edhe rolin e institucioneve të tjera, në procesin e programimit, financimit, zbatimit dhe monitorimit të fondeve dhe projekteve, sipas Programeve të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

ANEKS 4

Për konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën e pakushtëzuar të disa njërive të qeverisjes vendore përfshihen edhe fondet për mbulimin e kostos së plote të konvikteve të arsimit parauniversitar, ku përfshihen: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative, shpenzimet për mirëmbajtjen dhe investimet.

Njësite e qeverisjes vendore, që në transfertën e pakushtëzuar kanë të përfshirë koston e konvikteve të arsimit parauniversitar janë si më poshtë:

Bashkitë: Berat, Skrapar, Dibër, Mat, Durrës, Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Fier, Lushnjë, Elbasan, Cërrik, Gramsh, Korçë, Kolonjë, Lezhë, Mirditë, Kukës, Has, Shkodër, Malësi e Madhe, Vau-Dejë, Pukë, Tiranë, Kavajë, Vlorë dhe Sarandë.

Shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime shoqërore) janë llogaritur mbështetur mbi numrin e punonjësve për secilin konvikt sipas aneksit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 16.4.2008, “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1710, datë 29.12.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 16.04.2008”, për punonjësit edukativë (zëvendës drejtor dhe edukator).



Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e qeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Ministria e Arsimit dhe Sportit para fillimit të vitit fiskal 2015, duhet të dërgojë në njësitë e qeverisjes vendore gjithë kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me pagat dhe sigurimet shoqërore për konviktet e arsimit parauniversitar.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

VENDIM

Nr. 638, datë 22.7.2015

**PËR KUOTAT E PRANIMIT NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT
TË LARTË NË PROGRAMET E
STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË, NË
PROGRAMET E STUDIMEVE
JOUNIVERSITARE PROFESIONALE
DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA
TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË,
ME KOHË TË PLOTË, SI EDHE TARIFAT
E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK
2015 – 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, e të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2015 - 2016, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të

plotë, janë 20 211 të ndara, si më poshtë vijojnë:

- | | | |
|----|---|---------|
| a) | Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, për programet e studimeve jo universitare profesionale, si dhe për programet e integruara të studimit të ciklit të dytë | 19 651; |
| b) | Kuota për program të dytë studimi | 200; |
| c) | Kuota për transferim studimesh | 300; |
| c) | Kuota për shtetasit e huaj | 60. |

2. Kuotat e pranimeve të reja, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, përbëhen nga:

- | | | |
|-----|--|---------|
| a) | Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit | 18 986; |
| b) | Kuotat për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit | 600; |
| c) | Kuotat për të verbrit | 15; |
| c) | Kuotat për romët dhe ballkano-egjiptianët | 20; |
| d) | Kuotat për invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë | 15; |
| dh) | Kuotat për jetimët | 15. |

3. Kuotat e pranimit në programet e studimeve të ciklit të parë me kohë të plotë, programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, pasqyrohen në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimit për programet e studimeve të ciklit të parë, të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit, si Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegje. Këto kuota shpërndahen me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë. Rishpërndarja e këtyre kuotave kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, jo më vonë se data e parashikuar për fillimin e vitit akademik 2015 - 2016.

Kandidatët nga Republika e Kosovës, Republika e Maqedonisë, Republika e Malit të Zi dhe nga Prefektura e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, aplikojnë direkt në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Kriteret e vlerësimit dhe të pranimit të tyre në këto programe studimi përcaktohen me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe bëhen të njohura në media e shkruar dhe atë elektronike për të gjithë kandidatët e interesuar. Procedurat për procesin e përzgjedhjes dhe regjistrimit të kandidatëve fitues



duhet të përfundojnë përpara fillimit të vitit akademik 2015-2016.

5. Kuotat e pranimit për të verbrit, të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 2, të këtij vendimi, për romët dhe ballkano-egjiptianët, të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 2, të këtij vendimi, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuara në shkronjën “d”, të pikës 2, të këtij vendimi, dhe për jetimët, të përcaktuara në shkronjën “dh”, të pikës 2, të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve me statusin përkatës nga një komision me përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të komisionit të përbashkët, si dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve përcaktohen me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

6. Kuotat e pranimeve për shtetasit e huaj, të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ato shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe, si dhe në bazë të kërkesave individuale, të paraqitura në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit nga personat e interesuar.

7. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimeve të ciklit të parë me kohë të plotë, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, të vitit akademik 2015 - 2016, pasqyrohen në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Përrjashtimi apo reduktimi i tarifës së shkollimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Studenti, i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdon studimet.

9. Në çdo program studimi, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, në vitin akademik 2015 - 2016, 3 (tre) studentët e vitit të parë, me rezultatet më të larta në plotësimin e kriterëve të pranimit (pikët e fituara në sistemin meritë - preferencë), në programin e studimit përkatës, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit. Përrjashtim bën Universiteti i Arteve të Tiranës, në të cilin tre

studentët e vitit të parë, me rezultatet më të larta në plotësimin e kriterëve të pranimit (pikët e fituara në sistemin meritë–preferencë) në nivel fakulteti, nuk paguajnë tarifën vjetore të shkollimit.

10. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi, të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, si edhe kuotat për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, mbështetur dhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

11. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit bëhen sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

12. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi apo nga programe të mëparshme studimi të ciklit të parë në një program tjetër studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës së përgjithshme vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.

13. Kandidatët, që kanë përfunduar me sukses një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi, brenda numrit të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në një program të dytë studimi.

14. Kandidatët, të cilët aplikojnë për një program të parë studimi në vitin akademik 2015 - 2016, në programet e studimeve të ciklit të parë me kohë të plotë në: Universitetin e Arteve Tiranë, Universitetin e Sporteve të Tiranës, universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan (programi i studimit “Edukim fizik dhe sporte”), universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër (programet e studimit “Edukim fizik dhe sporte”, “Pedagogji muzikore” dhe “Pikturë e grafikë”), si dhe në universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës (programet e studimeve të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën, FASTIP), duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta (përfshirë këtu konkurset e pranimit), të vendosura nga vetë këto institucione publike të arsimit të lartë.

Kriteret e veçanta për këto programe studimi duhet t'i plotësojnë edhe kandidatët që kërkojnë të studiojnë në një program të dytë studimi.



15. Studentët, që vijojnë një program të dytë studimi, i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit, të përcaktuar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

16. Shtetasit e huaj, që vazhdojnë studimet në një program të parë apo të dytë studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen të njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë që vazhdojnë studimet në programet respektive të studimit në institucionet publike të arsimit të lartë, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje zyrtare shtetërore janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave të shkollimit.

17. Pranimi i studentëve në institucionet publike të arsimit të lartë bëhet nëpërmjet parimit Meritë - Preferencë dhe kryhet në dy raunde (aplikimi me dy formularët, A2 dhe A3).

17.1 Shpërndarja e fituesve në programe të ndryshme studimi, të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë, bëhet në mënyrë të informatizuar, duke u mbështetur në rezultatet e shkollës së mesme, të Maturës Shtetërore (merita), si dhe të përzgjedhjes së programeve të studimit (preferenca), të bërë nga vetë kandidati/ja. Raundi i parë (aplikimi me formularin A2) zhvillohet në dy faza: Faza I regjistrimi on-line dhe Faza II regjistrimi me dokumentacionet e kërkuara sipas udhëzimit përkatës të ministrit të Arsimit dhe Sportit në sekretariatë e fakulteteve pranë institucioneve të arsimit të lartë publik, ku janë shpallur fitues.

17.2 Kuotat, që mbeten të porealizuara për çdo program studimi pas aplikimit me formularin A2, rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bazë të propozimeve të institucioneve publike të arsimit të lartë.

17.2.1 Në raundin e dytë kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë maturantët kandidatë që kanë konkurruar në raundin e parë me të njëjtën renditje preferencash të atij raundi, me përjashtim të:

a) fituesve të preferencës së parë të cilët janë regjistruar në këtë program studimi;

b) maturantëve/kandidatëve të cilët nuk kanë kërkuar vazhdimin e konkurrimit për preferenca më të larta gjatë regjistrimit on-line dhe që rezultojnë të regjistruar në programin e studimit të preferuar.

17.2.2 Formulari A3 përfshin programet e studimit të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë me kuotat respektive të paplotësuara, të rishpërndara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Kanë të drejtë të plotësojnë formularin A3 të gjithë kandidatët, të cilët:

a) kanë marrë pjesë dhe kanë rezultuar fitues në provimet e Maturës Shtetërore, sesioni i parë, por nuk kanë plotësuar formularin A2;

b) kanë marrë pjesë dhe kanë rezultuar fitues në provimet e Maturës Shtetërore, në sesionin e dytë 2015;

c) kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë Republikës së Shqipërisë dhe u janë ekuivalentuar rezultatet e shkollës së mesme dhe provimet e Maturës Shtetërore;

ç) kanë plotësuar formularin A1Z në sesionin e dytë dhe rezultojnë kalues në provimet me zgjedhje.

18. Kuotat, që mbeten të porealizuara edhe pas regjistrimit të fituesve të shpallur nga aplikimi në raundin e fundit, nuk rishpallen.

19. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Provimeve, njësitë arsimore vendore (drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore) dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



TABELA PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT VJETORE TË SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, PROGRAMET E STUDIMEVE JOUNIVERSITARE PROFESIONALE, SI DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015 - 2016

EMËRTIMI I UNIVERSITETIT	ID_PROGRAMIT	EMËRTIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT	Kuota për program të parë studimi	Tarifa vjetore për program të parë	Tarifa vjetore për program të dytë
Universiteti i Tiranës	001	Histori	120	30,000	111,778
Universiteti i Tiranës	002	Gjeografi	120	30,000	111,778
Universiteti i Tiranës	003	Gjuhë - Letërsi	120	30,000	111,778
Universiteti i Tiranës	004	Gazetari	85	30,000	111,778
Universiteti i Tiranës	005	Arkeologji	45	30,000	111,778
Universiteti i Tiranës	006	Biologji	100	25,000	203,690
Universiteti i Tiranës	007	Bioteknologji	90	25,000	203,690
Universiteti i Tiranës	008	Matematikë	90	25,000	203,690
Universiteti i Tiranës	009	Fizikë	100	25,000	203,690
Universiteti i Tiranës	010	Informatikë	300	25,000	203,690
Universiteti i Tiranës	011	Kimi	90	25,000	203,690
Universiteti i Tiranës	012	Kimi dhe Teknologji Ushqimore	90	25,000	203,690
Universiteti i Tiranës	013	Kimi Industriale dhe Mjedisore	90	25,000	203,690
Universiteti i Tiranës	014	Inxhinieri Matematike dhe Informatike	120	25,000	203,690
Universiteti i Tiranës	015	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	200	25,000	203,690
Universiteti i Tiranës	016	Gjuhë Angleze	180	25,000	135,730
Universiteti i Tiranës	017	Gjuhë Frënge	110	25,000	135,730
Universiteti i Tiranës	018	Gjuhë Gjermane	110	25,000	135,730
Universiteti i Tiranës	019	Gjuhë Italiane	110	25,000	135,730
Universiteti i Tiranës	020	Gjuhë Greke	60	25,000	135,730
Universiteti i Tiranës	021	Gjuhë Turke	60	25,000	135,730
Universiteti i Tiranës	022	Gjuhë Ruse	60	25,000	135,730
Universiteti i Tiranës	023	Gjuhë Spanjolle me profil Gjuhë - Letërsi dhe Qytetërim Hispanik	70	25,000	135,730
Universiteti i Tiranës	024	Gjuhë Angleze (Sarandë)	50	25,000	135,730
Universiteti i Tiranës	025	Psikologji	100	40,000	111,778
Universiteti i Tiranës	026	Punë Sociale	100	40,000	111,778
Universiteti i Tiranës	027	Filozofi	80	40,000	111,778
Universiteti i Tiranës	028	Sociologji	80	40,000	111,778
Universiteti i Tiranës	029	Shkenca Politike	100	40,000	111,778
Universiteti i Tiranës	030	Administrim dhe Politika Sociale	100	40,000	111,778
Universiteti i Tiranës	031	Administrim - Biznes	400	35,000	86,374
Universiteti i Tiranës	032	Ekonomiks	70	35,000	86,374
Universiteti i Tiranës	033	Financë	400	35,000	86,374
Universiteti i Tiranës	034	Informatikë Ekonomike			



			200	35,000	86,374
Universiteti i Tiranës	035	Administrim- Biznes (Sarandë)	150	35,000	86,374
Universiteti i Tiranës	036	Drejtësi	600	40,000	63,341
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	037	Mjekësi e Përgjithshme	240	45,000	233,916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	038	Farmaci	90	45,000	233,916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	039	Stomatologji	55	45,000	233,916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	040	Infermieri e Përgjithshme	300	40,000	233,916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	041	Mami	80	35,000	233,916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	042	Teknikë e Lartë Laboratorike	60	35,000	233,916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	043	Fizioterapi	60	35,000	233,916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	044	Logopedi	40	35,000	233,916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	045	Imazheri	70	35,000	233,916
Universiteti Bujqësor i Tiranës	046	Menaxhim Agrobiznesi	110	35,000	86,374
Universiteti Bujqësor i Tiranës	047	Ekonomi dhe Politikë Agrare	85	30,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	048	Financë – Kontabilitet	110	30,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	049	Menaxhim i Turizmit Rural	70	25,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	050	Informatikë Biznesi	70	25,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	051	Ekonomiks i Aplikuar	70	25,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	052	Mbrojtje Bimësh	70	25,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	053	Hortikulturë	55	25,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	054	Prodhim Bimor	65	25,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	055	Zootehni dhe Biznes Blegtoral	70	25,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	056	Akuakulturë dhe Menaxhim Peshkimi	60	25,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	057	Agromjedis dhe Ekologji	110	25,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	058	Inxhinieri Agrare - Agromekanizim	70	25,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	059	Teknologji Agroushqimore	90	25,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	060	Vreshtari - Enologji	50	25,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	061	Mbarëshëm Pyesh	60	30,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	062	Përpunim Druri	60	30,000	144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	063	Mjekësi Veterinare	105	40,000	233,916
Universiteti Bujqësor i Tiranës	064	Menaxhim veterinar (2 vjecar)	60	25,000	50,000
Universiteti Politeknik i Tiranës	065	Inxhinieri Ndërtimi	100	35,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	066	Inxhinieri Hidroteknike	50	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	067	Inxhinieri Mjedişi	50	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	068	Arkitekturë (Arkitekt)	135	40,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	069	Arkitekturë (Urbanist)	75	40,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	070	Inxhinieri Gjeodezi	55	25,000	203,690



Universiteti Politeknik i Tiranës	071	Inxhinieri Elektrike (Automatizim i Industrisë)	60	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	072	Inxhinieri Elektrike (Energjetikë)	60	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	073	Inxhinieri Mekatronike	60	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	074	Inxhinieri Fizike	60	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	075	Inxhinieri Matematike	60	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	076	Inxhinieri Mekanike	145	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	077	Inxhinieri Tekstile dhe Modë	70	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	078	Inxhinieri Materiale	55	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	079	Inxhinieri Ekonomike	85	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	080	Inxhinieri Gjeologjike	70	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	081	Inxhinieri Gjeoburimesh	90	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	082	Inxhinieri Gjeoinformatikë	70	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	083	Inxhinieri Gjeomjedis	60	25,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	084	Inxhinieri Elektronike	60	30,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	085	Inxhinieri Informatike	60	30,000	203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	086	Inxhinieri Telekomunikacioni	60	30,000	203,690
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	087	Gjuhë - Letërsi	60	20,000	111,812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	088	Gjuhë dhe Kulturë Frënge	20	20,000	135,730
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	089	Gjuhë Angleze	50	20,000	111,812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	090	Mësuesi për Arsimin Fillor	60	20,000	111,812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	091	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	30	20,000	111,812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	092	Histori - Gjeografi	55	20,000	111,812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	093	Filozofi - Sociologji	50	20,000	111,812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	094	Matematikë - Fizikë	30	20,000	111,812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	095	Matematikë - Informatikë	30	20,000	111,812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	096	Biologji - Kimi	37	20,000	111,812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	097	Teknologji Informacioni	52	20,000	111,812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	098	Infermier e Përgjithshme	100	20,000	233,916
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	099	Mami (Infermier)	55	20,000	233,916
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	100	Administrim dhe Politika Sociale	65	20,000	233,916
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	101	Financë - Kontabilitet	100	20,000	86,374
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	102	Menaxhim	80	20,000	86,374
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	103	Administrim Biznesi në Marketing	35	20,000	86,374
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	104	Administrim Biznesi në Turizëm	45	20,000	86,374
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	105	Agroushqim	40	20,000	86,374
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	106	Agrobiznes	50	20,000	86,374
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	107	Inxhinieri Agronomike			



			55	20,000	86,374
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	108	Mjekësi e Bimëve dhe Hortikulturë	25	20,000	86,374
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	109	Gjuhë - Letërsi	100	25,000	126,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	110	Gjuhë -Letërsi Shqipe dhe Frënge	20	25,000	153,900
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	111	Histori - Gjeografi	80	25,000	126,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	112	Histori dhe Gjuhë Gjermane	20	25,000	153,900
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	113	Gjeografi dhe Gjuhë Italiane	45	25,000	153,900
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	114	Gjuhë Angleze	100	25,000	153,900
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	115	Gjuhë Gjermane	20	25,000	153,900
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	116	Gjuhë Frënge	25	25,000	153,900
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	117	Gjuhë Italiane	45	25,000	153,900
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	118	Gazetari	55	25,000	126,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	119	Gazetari - Anglisht	55	25,000	153,900
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	120	Gjuhë Shqipe dhe Rome	20	25,000	153,900
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	121	Biologji - Kimi	90	25,000	243,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	122	Matematikë - Fizikë	60	25,000	243,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	123	Teknologjitë e Informacionit	80	25,000	243,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	124	Teknologji Laboratori (2 vjeçar)	45	25,000	243,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	125	Fizikë Kompjuterike	40	25,000	243,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	126	Matematikë Informatike	30	25,000	243,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	127	Infermieri e Përgjithshme	120	25,000	243,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	128	Infermieri - Mami	75	25,000	243,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	129	Fizioterapi	75	25,000	243,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	130	Logopedi	60	25,000	243,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	131	Imazheri	60	25,000	243,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	132	Teknologji Laboratori	60	25,000	243,800
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	133	Mësuesi për Arsimin Fillor	80	25,000	138,700
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	134	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	75	25,000	138,700
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	135	Edukim Qytetar	65	25,000	138,700
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	136	Punonjës Social	80	25,000	138,700
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	137	Filozofi - Sociologji	70	25,000	138,700
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	138	Psikologji	70	25,000	138,700
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	139	Edukim Fizik dhe Sporte	60	25,000	233,916
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	140	Administrim - Biznes	80	25,000	92,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	141	Financë - Kontabilitet	60	25,000	92,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	142	Ekonomia dhe e Drejta	130	25,000	92,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	143	Informatikë Ekonomike	110	25,000	92,200



Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	144	Ekonomi Turizmi	60	25,000	92,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	145	Administrim Biznesi dhe Inxhinieri	55	25,000	92,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	146	Shkenca Juridike në Biznes	55	25,000	92,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	147	Shkenca Juridike në Sektorin Publik	65	25,000	92,200
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	148	Biologji - Kimi	25	20,000	203,690
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	149	Fizikë dhe Teknologji Informacioni	20	20,000	203,690
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	150	Matematikë - Fizikë	25	20,000	203,690
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	151	Matematikë-Informatikë	10	20,000	203,690
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	152	Teknologji Informacioni	20	20,000	203,690
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	153	Infermieri e përgjithshme	60	20,000	233,916
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	154	Infermieri Mami	15	20,000	233,916
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	155	Histori - Gjeografi	30	20,000	111,778
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	156	Gjuhë - Letërsi Shqipe	20	20,000	111,778
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	157	Gjuhë Letërsi Angleze	20	20,000	135,730
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	158	Gjuhë Letërsi Italiane	20	20,000	135,730
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	159	Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek	15	20,000	135,730
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	160	Histori dhe Gjuhë Italiane	20	20,000	135,730
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	161	Mësuesi për Arsimin Fillor	20	20,000	111,778
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	162	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	15	20,000	111,778
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	163	Kontabilitet - Financë	45	20,000	111,778
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	164	Administrim - Publik	30	20,000	111,778
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	165	Ekonomi Turizmi	10	20,000	111,778
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	166	Gjuhë – Letërsi	110	25,000	111,778
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	167	Gazetari dhe Komunikim	60	20,000	111,778
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	168	Histori	110	20,000	111,778
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	169	Gjeografi	95	20,000	111,778
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	170	Matematikë	60	20,000	203,690
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	171	Fizikë	30	20,000	203,690
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	172	Informatikë	75	20,000	203,690
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	173	Biologji - Kimi	75	20,000	203,690
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	174	Infermieri e Përgjithshme	82	20,000	233,916
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	175	Infermieri (Mami)	82	20,000	233,916
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	176	Infermieri (Fizioterapi)	30	20,000	233,916
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	177	Mësuesi për Arsimin Fillor	75	20,000	111,778
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	178	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	60	20,000	111,778
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	179	Psikologji	60	25,000	111,778
Universiteti "Luigi Gurakuqi" Shkodër	180	Punë Sociale			



			60	25,000	111,778
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	181	Edukim Fizik dhe Sporte	65	20,000	111,778
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	182	Financë - Kontabilitet	110	20,000	86,374
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	183	Administrim - Biznes	110	20,000	86,374
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	184	Turizëm	80	20,000	86,374
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	185	Gjuhë Angleze	70	20,000	135,730
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	186	Gjuhë Italiane	55	20,000	135,730
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	187	Gjuhë Gjermane	30	20,000	135,730
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	188	Gjuhë Frënge	30	20,000	135,730
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	189	Drejtesia	170	25,000	66,452
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	190	Pikturë e Grafikë	30	27,000	140,000
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	191	Pedagogji Muzikore	30	27,000	140,000
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	192	Matematikë	25	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	193	Fizikë	25	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	194	Shkenca Kompjuterike	55	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	195	Teknologji Informacioni	55	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	196	Informatikë	75	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	197	Inxhinieri Navale	45	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	198	Inxhinieri Mekanike	70	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	199	Navigacion	30	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	200	Kimi	15	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	201	Biologji	70	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	202	Inxhinieri Elektrike	40	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	203	Administrim Biznesi	120	20,000	86,374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	204	Menaxhim Turizmi	80	20,000	86,374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	205	Ekonomiks	100	20,000	86,374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	206	Financë	190	20,000	86,374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	207	Kontabilitet	50	20,000	86,374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	208	Marketing	50	20,000	86,374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	209	Mësuesi për Arsimin Fillor	75	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	210	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	65	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	211	Pedagogji e Specializuar	20	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	212	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	95	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	213	Gjuhë Angleze	100	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	214	Gjuhë Italiane	20	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	215	Histori - Gjeografi	70	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	216	Drejtesia	140	20,000	100,446



Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	217	Infermieri e Përgjithshme	160	20,000	233,916
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	218	Infermier Mami	60	20,000	233,916
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	219	Administrim Biznesi	50	25,000	86,374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	220	Menaxhim - Marketing	50	25,000	86,374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	221	Shkenca Ekonomike	50	25,000	86,374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	222	Financë -Kontabilitet	50	25,000	86,374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	223	Bankë Financë	50	25,000	86,374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	224	Menaxhim Hotel Restorant	50	25,000	86,374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	225	Menaxhim Turizëm Kulturor	50	25,000	86,374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	226	Menaxhim Turizëm Arkeologjik	50	25,000	86,374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	227	Drejtësi	80	25,000	146,232
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	228	Shkenca Politike	45	25,000	146,232
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	229	Administrim Publik	50	25,000	146,232
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	230	Politikë Ekonomike	50	25,000	146,232
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	231	Marrëdhënie me Publikun	50	25,000	146,232
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	232	Histori	50	25,000	146,232
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	233	Infermieri e Përgjithshme	47	25,000	247,950
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	234	Mami	35	25,000	247,950
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	235	Fizioterapi	40	25,000	247,950
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	236	Navigacion dhe Peshkim Detar	40	25,000	247,950
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	237	Teknikë Elektrike (2- vjeçar)	40	25,000	93,285
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	238	Hidroteknikë Ujësullës Kanalizime (2- vjeçar)	26	25,000	93,285
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	239	Asistencë Stomatologji (2- vjeçar)	30	25,000	93,285
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	240	Menaxhim Ndërtimi (2- vjeçar)	30	25,000	93,285
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	241	Menaxhim Transporti (2- vjeçar)	30	25,000	93,285
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	242	Asistencë Ligjore (2- vjeçar)	30	25,000	93,285
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	243	Asistencë Administrative (2- vjeçar)	30	25,000	93,285
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	244	Teknologji Automobilitash (2- vjeçar)	40	25,000	93,285
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	245	Teknikë e Rrjeteve Kompjuterike (2- vjeçar)	35	25,000	93,285
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	246	Informatikë Praktike (2- vjeçar)	30	25,000	93,285
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	247	Gjuhë Angleze	55	25,000	135,730
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	248	Mësuesi për Arsimin Fillor	50	25,000	111,778
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	249	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	50	25,000	111,778
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	250	Gjuhë Letërsi - Anglisht	50	25,000	111,778
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	251	Gjermanisht-Anglisht	45	25,000	111,778
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	252	Shkenca Kompjuterike	50	25,000	204,000
Universiteti "Aleksandër Moisiu"	253	Sistemet e Informacionit			



Durrës			50	25,000	204,000
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	254	Teknologji Informatiçoni	50	25,000	204,000
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	255	Matematikë - Informatikë	50	25,000	204,000
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	256	Informatikë - Anglisht	50	25,000	204,000
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	257	Multimedia dhe Televizioni Dixhital	30	25,000	204,000
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	258	Menaxhim i Bankave (Program në Gjuhë Angleze)	20	25,000	171,000
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	259	Menaxhim Hoteleri Turizëm (Program në Gjuhë Angleze)	15	25,000	171,000
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	260	Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (Program në Gjuhë Angleze)	15	25,000	171,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	261	Regji Filmi dhe Televizioni	14	40,000	220,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	262	Aktrim	12	40,000	220,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	263	Regji	12	40,000	220,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	264	Skenografi - Kostumografi	12	40,000	220,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	265	Koreografi	14	40,000	220,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	266	Pikturë	65	40,000	280,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	267	Skulpturë	12	40,000	280,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	268	Muzikologji	3	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	269	Kompozim	4	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	270	Dirizhim	4	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	271	Piano	8	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	272	Violinë	8	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	273	Violonçel	4	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	274	Violë	4	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	275	Kitarë	8	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	276	Kontrabas	2	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	277	Flaut	2	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	278	Oboe	2	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	279	Klarinetë	3	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	280	Fagot	2	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	281	Korno	3	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	282	Trombë	3	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	283	Trombonë	3	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	284	Bastub	1	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	285	Kanto	8	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	286	Pedagogji Muzikore	15	40,000	320,000
Universiteti i Arteve, Tiranë	287	Fizarmunikë Klasike	2	40,000	320,000
Universiteti i Sporteve të Tiranës	288	Shkencat e Lëvizjes	110	35,000	233,916
Universiteti i Sporteve të Tiranës	289	Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit	100	35,000	233,916
		Totali	18,986		



VENDIM

Nr. 644, datë 22.7.2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 11, DATË 14.1.2015, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOQSHME PËR VITIN 2015 NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet “... 2 053 veta ...”.

2. Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit, në ndarjet “(7) Ministria e Financave” dhe “(9) Ministria e Shëndetësisë” shtohen nëndarjet, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në pikën 2, pas fjalëve “... në Ministrinë e Financave ...” shtohen “... dhe dy specialistët e kontraktuar nga Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile ...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Emri i Institucionit	Nr. Punonjës	Emërtesa	Koha ditore	Periudhë kohore
(7) Ministria e Financave	1			
Aparati i Ministrisë (Drejtorja e Procesimit të Biznesit)	1	Specialist	8 orë / ditë	korrik - dhjetor
(9) Ministria e Shëndetësisë	6			
Aparati i Ministrisë	3	Receptionist	8 orë/ditë	korrik - dhjetor
Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit	1	Receptionist	8 orë/ditë	korrik - dhjetor
Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim	1	Receptionist	8 orë/ditë	korrik - dhjetor
Klinika Stomatologjike Universitare	1	Receptionist	8 orë/ditë	korrik - dhjetor

VENDIM

Nr. 645, datë 22.7.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE DHE
TË PROCEDURAVE TË KALIMIT TË
BASHKËPRONËSISË SË DETYRUESHME
MBI TRUALLIN E LIRË, NË ZONAT ME
PËRPARËSI TURIZMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 9/1, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGGJITHSHME

1. Procedura e kalimit të pronësisë apo bashkëpronësisë së detyrueshme për truallin e lirë

(sipas kuptimit të shkronjës “g”, të nenit 2, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar) kryhet nga ALUIZNI, pas përfundimit të shitjes së truallit të njëjësive ndërtimore.

2. Regjistrimi në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme i kontratës së fitimit të pronësisë mbi njësinë ndërtimore bëhet vetëm pasi të përfundojnë procedurat e kalimit të pronësisë mbi truallin e lirë, brenda kufijve të zonës së stimuluar.

3. Personi i stimuluar mund të kërkojë blerjen e të gjithë truallit të lirë brenda zonës së stimuluar, nëse ka përfunduar njësitë ndërtimore dhe destinacioni i tyre është veprimtaria e stimuluar.

4. Kalimi i pronësisë apo bashkëpronësisë së detyrueshme mbi truallin e lirë nëpërmjet blerjes bëhet me kërkesë të personit të stimuluar dhe/ose subjekteve të interesuara. Në rastin kur nuk ka



kërkesë për kalimin e së drejtës së pronësisë, truall i lirë mbetet pronë shtetërore. I njëjti rregullim vlen edhe për pjesën takuese të truallit të lirë për subjektet që gëzojnë njësi ndërtimore brenda zonës së stimuluar dhe nuk kanë kërkuar kalimin në bashkëpronësi të detyrueshme.

5. Bashkëpronësia e detyrueshme mbi truallin e lirë, sipas përcaktimeve të nenit 9/1, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, është e patjetërsueshme dhe në pjesë të barabarta.

6. Personat e stimuluar, që kanë lidhur marrëveshje qiraje dhe zhvillimi, si dhe janë pajisur me lejet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit, deri më 1 tetor 2014, kanë të drejtë të blejnë të gjithë truallin brenda zonës së stimuluar edhe në rastin kur njësitë ndërtimore janë në proces zhvillimi.

Për këtë kategori personash të stimuluar ALUIZNI:

a) harton relacionin dhe planin e rievimit me të dhënat e zonës së stimuluar sipas sipërfaqes së përcaktuar në marrëveshjen e qirasë dhe zhvillimit;

b) kalon të drejtën e pronësisë për sipërfaqen e truallit të përcaktuar në marrëveshjen e qirasë dhe zhvillimit. Në çdo rast, gjatë kalimit të së drejtës së pronësisë duhet të respektohen kufizimet e përcaktuara në nenin 84, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

II. AFATET DHE PROCEDURAT E ZBATUESHME PËR BLERJEN DHE KALIMIN E BASHKËPRONËSISË

7. Brenda një muaji nga përfundimi i procesit të parashikuar në nenin 9, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, të ndryshuar, ALUIZNI njofton me shkrim personin e stimuluar për blerjen e truallit të lirë brenda zonës së stimuluar. Në përmbajtjen e njoftimit përfshihet edhe informacioni për alternativat e kalimit të pronësisë mbi truallin e lirë.

8. Nëse personi i stimuluar nuk paraqet kërkesë për blerjen e të gjithë truallit të lirë ose për kalimin e tij në bashkëpronësi të detyrueshme, brenda një muaji nga marrja dijeni për njoftimin zyrtar, vijohet me njoftimin e subjekteve të interesuara për të drejtën e tyre për këtë bashkëpronësi.

9. Sipas pikës 8, të këtij vendimi, afati për paraqitjen e kërkesës nga subjektet e interesuara është një muaj nga data e marrjes dijeni për njoftimin.

10. Kur personi i stimuluar nuk përmbush kushtet e pikës 3, të nenit 9/1, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, të ndryshuar, atëherë ai dhe subjektet e interesuara njoftohen vetëm për mundësinë e kalimit të bashkëpronësisë së detyrueshme mbi truallin e lirë.

11. Njoftimet sipas pikave 7, 8 dhe 10, të këtij vendimi, përmbajnë edhe informacionin për vlerën e truallit dhe/ose të pjesës takuese për t'u paguar në secilin rast.

12. Përlogaritja e detyrimit financiar për truallin e lirë bëhet referuar zërit kadastral sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

13. Kalimi i pronësisë mbi truallin brenda zonës së stimuluar, sipas pikës 6, të këtij vendimi, bëhet referuar çmimit të truallit, në përputhje me vlerën e pronës së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

14. Afati për shlyerjen e plotë të detyrimit financiar është një muaj nga data e paraqitjes së kërkesës përkatëse (për blerjen e tërësisë së truallit ose për kalimin e tij në bashkëpronësi të detyrueshme).

15. Me shlyerjen e pjesës takuese të detyrimit, ALUIZNI lidh kontratën e shitjes së truallit të lirë. Modelet e kontratave miratohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

16. Në rast të mosshlyerjes së vlerës përkatëse të truallit të lirë nga subjektet që kanë paraqitur kërkesë, pjesa përkatëse mbetet në pronësi shtetërore.

17. Për subjektet e interesuara apo personat e stimuluar, që i kanë regjistruar kontratat e fitimit të pronësisë mbi njësitë ndërtimore në ZVRPP, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, zbatohen të njëjtat afate dhe procedura të përcaktuara në këtë vendim.

18. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM**

Nr. 646, datë 22.7.2015

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE E TË KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES SË ZHVILLUESIT NË ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I**DISPOZITA TË PËRZGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së zhvilluesit në zonën teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ligj”, ligji nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, i ndryshuar.

2. “Zonë”, “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”.

3. “Institucion përgjegjës”, ministria përgjegjëse për ekonominë.

KREU II**PROCEDURAT DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË ZHVILLUESIT**

Neni 3

Zhvilluesit e zonës

1. Zhvillues i zonës mund të jetë një institucion shtetëror ose çdo person juridik, vendas ose i huaj.

2. Përcaktimi i institucionit shtetëror në rolin e zhvilluesit bëhet në vendimin e Këshillit të Ministrave për shpalljen e zonës.

Neni 4

Procedurat e përzgjedhjes së zhvilluesit

Procedurat e përzgjedhjes së zhvilluesit janë, si më poshtë:

1. Procedurë konkurruese.
2. Procedurë me aplikim, në pronë private.

Neni 5

Procedura konkurruese

1. Procedura konkurruese fillon me publikimin e njoftimit për kontratën nga institucioni përgjegjës në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Institucioni përgjegjës kualifikon kandidatët /ofertuesit të cilët përmbushin kërkesat minimale për kualifikim të publikuara dhe më pas i krahason ofertat midis kandidatëve/ofertuesve duke përzgjedhur ofertuesin e vlerësuar me pikët maksimale sipas kriterëve të vlerësimit.

3. Kriteret për kualifikim:

A. Kriteret administrative-ligjore:

a) Çdo kandidat/ofertues për të marrë pjesë në procedurat e vlerësimit do të kualifikohet pasi të ketë përmbushur kriteret e mëposhtme:

i) Të mos jetë në proces falimentimi dhe kapitalet e tij të mos jenë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

ii) Të mos jetë subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe nuk ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose nuk ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedure tjetër të ngjashme;

iii) Të mos jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

iv) Të ketë përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

v) Të ketë përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

b) Kërkesat e nënpikave “i-iii” plotësohen me dorëzimin e ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, si dhe ekstraktin mbi



historikun e subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe me vërtetim nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e këtyre dokumenteve.

c) Kërkesat e nënpikave “iv-v” plotësohen me dorëzimin e vërtetimit të lëshuar nga administrata tatimore.

ç) Kandidati/ofertuesi i huaj duhet të vërtetohet se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendura nuk lëshohen në shtetin e origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim nga ana e kandidatit/ofertuesit.

B) Kriteret teknike:

a) Punime të ngjashme të realizuara dhe të përfunduara me sukses;

b) Licencat profesionale që lidhen me ekzekutimin e punimeve sipas objektit të kontratës;

c) Kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve;

ç) Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të ofertuesit dhe numrit të stafit drejtues;

d) Dëshmi të mjeteve, pajisjeve teknike që mund të vihen në dispozicion të kandidatit/ofertuesit për të përmbushur kontratën.

C) Kriteret financiare:

a) Kopje të certifikuara të bilanceve të një ose më shumë viteve, të paraqitura në autoritetet përkatës edhe raportet e auditit financiar, të certifikuara nga një subjekt i licencuar auditimi;

b) Kopje të deklaratave të xhiros vjetore.

4. Kriteret për vlerësim:

A. Kriteret teknike në lidhje me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të zonës:

a) Propozimin e projektit teknik, i cili duhet të përmbajë:

- projektidenë;

- të dhëna për teknologjinë e përdorur;

- të dhëna për cilësinë e infrastrukturës dhe vlerat e investimit;

- planin teknik dhe inxhinierik të zonës në përputhje me standardet e përdorura për ndërtim dhe planifikimin urban;

- planin e zbatimit, planin operacional dhe metodat për funksionimin dhe mirëmbajtjen e zonës;

- programin për tërheqjen e industrive të reja;

- llojin e aktiviteteve ekonomike në zonë.

B. Kriteret në lidhje me ndikimin mjedisor:

a) Impakti mjedisor i investimeve dhe funksionimit të zonës;

b) Lloji i aktivitetit duke u bazuar te studimet mjedisore të zonës.

C. Kriteret në lidhje me ndikimin social:

a) Numrin e të punësuarve;

b) Programin për përgjegjësinë sociale;

c) Trajnimin e punonjësve dhe transferimin e teknologjisë;

ç) Lidhjet me ekonominë vendase jashtë zonës.

Ç. Kohëzgjatja e punimeve:

a) Grafiku, fazat dhe afatet e ekzekutimit të investimeve për zhvillimin e zonës.

D. Kriteret në lidhje me kapacitetin financiar të kompanisë dhe me mundësinë e financimit të projektit:

a) Propozimin e planbiznesit, i cili duhet të përmbajë:

- Shpenzimet kapitale për kryerjen e investimit në zonë;

- Shpenzimet për kostot operacionale dhe të ardhurat;

- Tarifën e përdorimit të zonës;

- Garanci bankare për kapitalin e nevojshëm financiar për kryerjen e investimit në zonë.

5. Institucioni përgjegjës mund të vendosë kriteret të tjera të cilat lidhen ngushtë me qëllimin dhe strategjinë e zhvillimit të zonës.

6. Institucioni përgjegjës në dokumentet e konkurrimit publikon metodologjinë e vlerësimit dhe krahasimit të kandidatëve/ofertuesve për përzgjedhjen e zhvilluesit.

7. Kostot e organizimit të procedurave konkurruese. Shpenzimet për mbulimin e kostove për procedurat e publikimit, hartimit të dokumentacionit dhe konsulencës së specializuar përballohen nga kandidati/ofertuesi fitues.

8. Kriteret e vlerësimit përcaktohen në vendimin për shpalljen e zonës.

Neni 6

Organizimi i procedurës konkurruese

Institucioni përgjegjës nxjerr urdhrin për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e zhvilluesit, ku përcaktohen:

1. Njësia për Hartimin e Dokumenteve dhe organizimin e procedurave konkurruese (Njësia e Hartimit të Dokumenteve);

2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (Komisioni), i cili përbëhet nga përfaqësues të institucionit përgjegjës dhe, sipas rastit, nga përfaqësues të ministrive apo të institucioneve të



tjera, të cilët gjykohen që kanë lidhje me aktivitetin që do të kryhet në zonë;

3. Kontraktimi i ekspertëve të përkohshëm që asistojnë Njësinë e Hartimit të Dokumenteve dhe/ose Komisionin në kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 7

Dokumentet e procedurës konkurruese

1. Institucioni përgjegjës përgatit dhe publikon në faqen zyrtare të institucionit dokumentet standarde të cilat do të përdoren për zhvillimin e procedurave konkurruese për përzgjedhjen e zhvilluesit të zonës.

2. Njësia e Hartimit të Dokumenteve harton dokumentet e procedurës konkurruese që do të përdoren gjatë procedurave të përzgjedhjes së zhvilluesit, të cilat përmbajnë:

- a) formularin e njoftimit të kontratës;
- b) udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;
- c) kriteret e kualifikimit dhe vlerësimit;
- ç) formularin për deklarimin e konfliktit të interesit;
- d) formularin e ofertës;
- dh) formularin e sigurimit të ofertës,
- e) formularin e njoftimit të fituesit;
- ë) formularin e skualifikimit të kandidatëve/ofertuesve;
- f) formularin e ankesës;
- g) kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të kontratës.
- gj) formularin e sigurimit të kontratës;
- h) formularin për publikimin e kontratës fituese;
- i) termat e referencës.

Neni 8

Udhëzime për mënyrën e zbatimit të procedurës konkurruese

1. Informacion i përgjithshëm. Formulari i njoftimit të kontratës përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t'u krijojë mundësinë kandidatëve/ofertuesve të marrin pjesë ose jo në procedurat konkurruese. Në këtë informacion përfshihen emri dhe adresa e institucionit përgjegjës, objekti i kontratës, referenca e njoftimit dhe procedura konkurruese, kohëzgjatja e kontratës, kërkesat për kualifikim në lidhje me kapacitetet administrativo-ligjore, teknike dhe ekonomike-financiare, kriteret e

shpalljes së fituesit, vendi, metodat dhe kostoja për marrjen e dokumenteve të procedurës konkurruese; vendi, data dhe ora për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre; gjuha/gjuhët e ofertave e të dokumenteve, informacione të mëtejshme të konsideruara si të nevojshme nga institucioni përgjegjës. Formulari botohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, në *website*-in e institucionit përgjegjës dhe institucionit i cili merret me promovimin e investimeve, si dhe në shtypin ndërkombëtar dhe/ose vendas sipas rastit. Botimi bëhet në të paktën një gazetë ndërkombëtare, të njohur në tregjet e kapitaleve dhe financiare.

2. Udhëzimet për ofertuesit. Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës. Në to jepet informacion, midis të tjerave, për vendndodhjen e zonës, statusin e truallit mbi të cilën do të ndërtohet, lidhjen me infrastrukturën e jashtme, kushtet gjeoteknike dhe hidrogeologjike të tokës nëse disponohen, për infrastrukturën rrugore, sistemin e kanalizimeve të ujërave, sistemin e ujërave të pijshme dhe industriale, sistemin energjetik, informacion për tregun e punës.

Gjithashtu, mund të organizohet edhe një konferencë paraprake, ku të gjithë kandidatët/ofertuesit mund të kërkojnë sqarime për sa i përket ndonjë paqartësie që lind gjatë përgatitjes së procedurës konkurruese.

Kërkesat për sqarime duhet të paraqiten me shkrim, jo më vonë se 5 (pesë) ditë para përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave, dhe përgjigjet përkatëse të institucionit përgjegjës duhet t'u dërgohen të gjithë kandidatëve/ofertuesve që kanë kërkuar dokumentet e procedurës konkurruese, pa asnjë përjashtim.

Çdo amendim ose ndryshim në dokumentet e procedurës konkurruese duhet t'i komunikohet çdo kandidati/ofertuesi të interesuar në përputhje me rregullat e mësipërme.

Në këtë rast, afati i dorëzimit të ofertave mund të shtyhet në përputhje me rrethanat, por jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë.

Në udhëzime duhet të jepen informacione për sa i përket procedurës së rishikimit dhe dorëzimit të ankesave.

3. Formulari i ofertës plotësohet nga kandidatët/ofertuesit për të gjitha kriteret e



vlerësimin dhe përmban të dhëna për konfirmimin e kandidatit/ofertuesit se ai/ajo e ka shqyrtuar dhe pranuar përmbajtjen e dokumenteve të procedurës konkurruese; autorizon institucionin përgjegjës të verifikojë informacionin/dokumentet bashkëngjitur me ofertën; zotohet të ekzekutojë kontratën pa asnjë rezervë ose kufizim, në përputhje me projektin, specifikimet teknike apo termat e referencës, dhe me vlerën e deklaruar në ofertë. Kandidatëve/ofertuesve të huaj, në shtetet e të cilëve nuk mund të lëshohen dokumente të tilla, do t'u pranohen dokumentet në formën e deklaratës me shkrim, nën përgjegjësinë e tyre. Çdo e dhënë e rreme përbën shkak ligjor për skualifikim të kandidatit/ofertuesit.

4. Formulari i sigurimit të ofertës shërben si një masë mbrojtëse për institucionin përgjegjës, në rastet e ofertave të papërgjegjshme apo tërheqjes në mënyrë të njëanshme pas hapjes së tyre. Sigurimi i ofertës ka formën e një depozit e apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë aktivitet. Kandidatët/ofertuesit duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, me vlerë nga 7 milionë deri në 15 milionë lekë, të përcaktuar në dokumentet e procedurës konkurruese. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm për 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë nga afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave, por dokumentet e procedurës konkurruese mund të parashikojnë një periudhë të ndryshme vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Lëshuesi i sigurimit të ofertës duhet të mos vendosë asnjë kusht për pagimin dhe të paguajë shumën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e një kërkesë zyrtare nga institucioni përgjegjës.

5. Formulari i sigurimit të kontratës garanton institucionin përgjegjës në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, kandidati/ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t'i dorëzojë institucionit përgjegjës një sigurim kontrate prej 1% të vlerës së investimit. Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie bankare. Nëse kandidati/ofertuesi i përzgjedhur nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të përcaktuar në njoftimin e fituesit, atëherë institucioni përgjegjës konfiskon sigurimin e ofertës dhe negocion për lidhje të kontratës me kandidatin/ofertuesin e renditur i dyti në klasifikimin përfundimtar.

6. Formulari i njoftimit të fituesit. Pas miratimit të klasifikimit nga titullari i institucionit përgjegjës, kandidati/ofertuesi i suksesshëm duhet të njoftohet me shkrim për pranimin e ofertës së tij dhe për fillimin e negociimit të kontratës. Njoftimi duhet të përmbajë: referencën e procedurës, emrin dhe adresën e saktë të kandidatit/ofertuesit të shpallur fitues, përshkrimin e projektit apo shërbimit të zhvilluesit, kohëzgjatjen e kontratës dhe vlerën e kontratës, termat e kontratës, emrat dhe vlerën e kandidatëve/ofertuesve të tjerë, emrat e kandidatëve/ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit, si dhe kërkesën për fillimin e negociimit të kontratës, me kusht që të jetë bërë sigurimi i kontratës.

7. Formulari i skualifikimit të ofertuesve përmban shkaqet kur një kandidat/ofertues nuk mund të kualifikohet në procedurën konkurruese, sepse oferta është e pavlefshme. Institucioni përgjegjës duhet të kthejë ose të çlirojë sigurimin e ofertës pas skualifikimit.

8. Formulari i publikimit të termave kryesorë të kontratës me zhvilluesin përmban kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, të cilat përfshijnë tërësinë e punëve dhe shërbimeve, të drejtat dhe detyrimet thelbësore ndërmjet institucionit përgjegjës dhe zhvilluesit, si dhe detyrimet që lidhen me ekzekutimin, mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratës.

9. Formulari i ankesës i shërben kandidatëve/ofertuesve për dorëzimin e ankesës administrative, lidhur me veprimet ose mosveprimet e institucionit përgjegjës. Formulari i ankesës përmban udhëzimet e nevojshme për plotësimin dhe nënshkrimin e tij.

Neni 9

Bashkimi i përkohshëm i operatorëve

1. Operatorët ekonomikë mund të ofertojnë të vetëm ose të krijojnë grupe operatorësh ekonomikë dhe të ofertojnë si një kandidat i vetëm. Në rast të bashkimit të grupeve të operatorëve ekonomikë, institucioni përgjegjës duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

2. Bashkimi i operatorëve duhet të krijohet me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit dhe elementet konkrete që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi, e cila



nuk mund të jetë më pak se 11%. Ndërsa operatori drejtues i grupit nuk mund të ketë më pak se 35%.

3. Oferta mund të paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës së përzgjedhjes, edhe gjatë zbatimit të kontratës.

4. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

5. Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat teknike dhe financiare duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë/shërbim të përcaktuara në aktmarrëveshje.

6. Operatori ekonomik, pjesëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon gjatë fazave të përzgjedhjes dhe pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet.

7. Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, institucioni përgjegjës mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, i caktuar si përfaqësues i grupit dhe i propozuar nga anëtarët e tjerë jopërfaqësues, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, teknike dhe financiare për të zbatuar kontratën, përndryshe, institucioni përgjegjës mund të tërhiqet nga kontrata. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, nëse përfaqësuesi i grupit nuk cakton një zëvendësues, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i grupit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.

Neni 10

Njësia e Hartimit të Dokumenteve

1. Njësia e Hartimit të Dokumenteve është përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të procedurës konkurruese, në përputhje me këtë vendim dhe me legjislacionin në fuqi.

2. Njësia e Hartimit të Dokumenteve kryesohet nga kryetari dhe përbëhet nga jo më pak se tre persona me të paktën një jurist në përbërjen e saj. Njësia cakton një person, i cili është përgjegjës për sqarimin e kandidatëve/ofertuesve dhe për shpërndarjen e dokumenteve të konkurrimit. Shtyrja e afatit kohor, nëse kërkohet si rezultat i modifikimit të dokumenteve të procedurës konkurruese, hyn në fuqi vetëm pas miratimit me shkrim nga titullari i institucionit përgjegjës.

3. Pas hartimit të dokumenteve të procedurës konkurruese dhe miratimit nga titullari i institucionit përgjegjës, publikohet formulari për njoftimin e kontratës. Në këtë njoftim duhet të bëhet e qartë ora, data dhe adresa për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre.

Neni 11

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përbëhet nga jo më pak se 5 persona, specialistë të fushës përkatëse të institucionit përgjegjës, dhe, sipas rastit, nga përfaqësues të ministrive apo të institucioneve të tjera, të cilët gjykohen që kanë lidhje me aktivitetin që do të kryhet në zonë dhe është përgjegjës për shqyrtimin e ofertave. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek.

2. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të procedurës konkurruese nuk mund të emërohen anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Kryetari i Komisionit përzgjidhet mes zyrtarëve drejtues të institucionit përgjegjës. Komisioni duhet të zbatojë detyrat e tij në pavarësi të plotë dhe, nëse kërkohet ndonjë sqarim në lidhje me dokumentet e procedurës, konkurruese, këto merren nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve.

3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk kryen asnjë veprim tjetër përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këtë vendim.

4. Nuk mund të marrin pjesë në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave personat që kanë konflikt interesi me ofertuesit sipas kuptimit të ligjit “Për konfliktin e interesit”. Anëtarët e Komisionit dhe çdo person që ka marrë pjesë në procedurën e hartimit të dokumenteve kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertës.



Neni 12

Dorëzimi i ofertave

1. Ofertat duhet të dorëzohen dorazi në adresën e përcaktuar në dokumentet e procedurës konkurruese brenda afatit kohor të specifikuar në dokumentet e procedurës konkurruese, të përcaktuar si afati i fundit për dorëzimin e ofertave. Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në njoftimin e institucionit përgjegjës nuk do të shqyrtohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe do t'i kthehet e pahapur ofertuesit.

2. Ofertat do të dorëzohen në dy zarfe ku në njërin duhet të jetë shënuar “Origjinal” dhe te tjetri “Kopje”. Institucioni përgjegjës përcakton në dokumentet e procedurës konkurruese numrin e kopjeve që duhet të paraqesë kandidati/ofertuesi.

3. Zarfet do të paraqiten sipas përcaktimit në dokumentet standarde të procedurës konkurruese. Zarfet duhet të jenë të vulosura me vulën e kandidatit/ofertuesit pjesëmarrës në konkurrim. Mosparaqitja sipas përcaktimit apo mungesa e një elementi të përcaktuar për prezantimin e tij e bën ofertën të pavlefshme. Në këtë rast, oferta do të skualifikohet dhe dokumentacioni nuk do t'i kthehet kandidatit/ofertuesit.

4. Afati për paraqitjen e ofertave është jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data në të cilën është botuar formulari për njoftimin e kontratës.

Neni 13

Hapja e ofertave

Hapja e ofertave është publike. Hapja dhe vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave bëhet, si më poshtë vijon:

1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave lexon ofertat në prani të kandidatëve/ofertuesve, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim. Gjatë fazës së hapjes dhe vlerësimit marrin pjesë edhe anëtarë të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të procedurës konkurruese, por nuk kanë të drejtë për të votuar. Ata mund të japin mendime vetëm kur u kërkohet, si dhe kryejnë vetëm funksione të karakterit të ndihmës, si: mbajtjen e procesverbalit, sistemimin dhe ruajtjen e dokumenteve etj.

2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave lexon emrin dhe adresën e kandidatit/ofertuesit dhe hap zarfin përkatës. Pasi hap zarfin, lexon me zë të lartë dokumentet e kualifikimit administrativo-ligjor,

teknik dhe financiar. Më pas, hap ofertat teknike dhe ofertat financiare. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave u komunikon përfaqësuesve ditën, vendin dhe orën për klasifikimin përfundimtar të kandidatëve/ofertuesve dhe më pas vazhdon punën për shqyrtimin e ofertave.

3. Bazuar në ofertat e pranuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave harton renditjen përfundimtare, e cila duhet të komunikohet në kohën e përcaktuar në dokumentet e konkurrimin. Afati i vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është deri në 30 (tridhjetë) ditë. Në raste të veçanta, me kërkesë të argumentuar të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, institucioni përgjegjës mund ta ndryshojë këtë afat.

4. Nëse më shumë se një ofertë ka të njëjtën numër pikësh, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të kandidatëve/ofertuesve.

5. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i vlerësimit, përgatit raportin përmbledhës dhe ia propozon fituesin titullarit të institucionit përgjegjës.

Raporti përmban:

- i) objektin e kontratës;
- ii) një përmbledhje të procedurës së ndjekur;
- iii) numrin e ofertave të paraqitura dhe një përmbledhje për çdo ofertë;
- iv) kriteret e vlerësimit të ofertave dhe vlerësimin sipas këtyre kriterëve të secilës ofertë;
- v) renditjen e kandidatëve/ofertuesve sipas vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
- vi) ankesat, nëse ka.

Neni 14

Procedura me aplikim në pronë private

Kandidati zhvillues i nënshtrohet procedurës së mëposhtme:

1. Kandidati zhvillues aplikon pranë institucionit përgjegjës duke paraqitur studimin e parafizibilitetit cili duhet të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 5, të këtij vendimi, dhe aktin e pronësisë së zonës së kërkuar ose, në rastet kur kandidati nuk është pronar i zonës, marrëveshjen me pronarët e pasurive të përfshira në zonë.

2. Institucioni përgjegjës bën vlerësimin paraprak në mënyrë që të përcaktojë nëse:

a) objektivat e projektit i shërbejnë interesit publik dhe përshtaten me strategjitë sektoriale apo rajonale të zhvillimit;

b) nuk ka kufizime për zbatimin e projektit;



c) projekti mund të zbatohet siç është planifikuar, duke përdorur teknologjitë e propozuara dhe pa rreziqe të arsyeshme teknike;

ç) projekti ka qëndrueshmëri ekonomike dhe përshtatshmëri financiare;

d) projekti siguron përshpejtimin e zhvillimit rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut shqiptar me atë ndërkombëtar, si dhe përshpejtimin e qarkullimit të mallrave e të kapitaleve.

Pas kryerjes së vlerësimit paraprak, institucioni përgjegjës shprehet përpranueshmërinë e aplikimit. Nëse aplikimi vlerësohet i pranueshëm, i kërkohet kandidatit paraqitja e studimit të fizibilitetit.

3. Në bazë të studimit të fizibilitetit, institucioni përgjegjës, në përputhje me nenin 4, të ligjit, i propozon Këshillit të Ministrave shpalljen e zonës dhe zhvilluesin e saj.

4. Institucioni përgjegjës nxjerr udhëzimin për zbatimin e kësaj procedure.

Neni 15

Ankimi në institucionin përgjegjës

Çdo kandidat/ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të konkurrimit kur gjykon se një vendim i institucionit përgjegjës është marrë në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke vepruar, si më poshtë vijon:

1. Ankesa i paraqitet me shkrim institucionit përgjegjës brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga data kur ankimesi është vënë në dijeni për mospranimin e ofertës.

2. Me marrjen e ankesës me shkrim, institucioni përgjegjës pezullon vazhdimin e procedurës, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor.

3. Ankesa në institucionin përgjegjës bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar dhe dokumentacioni përkatës e vendimi institucionit përgjegjës. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

4. Institucioni përgjegjës shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 (shtatë) ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia

njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

Neni 16

Ankimi në gjykatë

Kundër vendimit të institucionit përgjegjës ankuesi ka të drejtë që brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni, të bëjë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në gjykatën kompetente. Shqyrtimi i këtij ankimi në gjykatë nuk pezullon vazhdimin e procedurave.

Neni 17

Miratimi dhe publikimi i fituesit

1. Pas miratimit të raportit përmbledhës nga titullari i institucionit përgjegjës, siç parashikohet në këtë vendim, kandidati/ofertuesi i suksesshëm njoftohet me shkrim për pranimin e ofertës dhe për lidhjen e kontratës. Ky njoftim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Njoftimi duhet të përmbajë:

a) emrin dhe adresën e kandidatit/ofertuesit të shpallur fitues;

b) kohëzgjatjen e kontratës dhe vlerën e kontratës;

c) emrat dhe vlerën e kandidatëve/ofertuesve të tjerë;

ç) emrat e kandidatëve/ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit;

d) informacion nëse ka pasur ankesa;

dh) kërkesën që kontrata të nënshkruhet, me kusht që të jetë bërë sigurimi i saj.

Neni 18

Negocimi i kontratës

Institucioni përgjegjës do të ftojë kandidatin /ofertuesin e shpallur fitues të fillojë procedurat e negocimit të kontratës menjëherë pas publikimit të njoftimit të fituesit. Procedurat e negocimit përfundojnë jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e këtij publikimi.

Neni 19

Kontrata

1. Kontrata midis institucionit përgjegjës dhe zhvilluesit reflekton termat e referencës së procedurës së konkurrimit dhe kriteret sipas të cilave është bërë përzgjedhja e zhvilluesit të cilat janë kushte të panegociueshme të kontratës.



2. Kontrata përmban kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi, si dhe parashikon ato terma që vlerësohen të përshtatshëm nga palët, të tilla si:

a) përkufizime, interpretime, natyra dhe objekti i punëve që duhet të kryhen dhe shërbimet që duhet të jepen nga zhvilluesi;

b) kohëzgjatja e kontratës;

c) pronësia e aseteve të projektit dhe detyrimet e palëve, sipas rastit, për vënien në dispozicion të vendit të projektit ku do të zhvillohet zona dhe çdo lehtësi tjetër të mundshme;

ç) procedurat për rishikimin dhe miratimin e projekteve inxhinierike, të planeve të ndërtimit dhe specifikimeve nga institucioni përgjegjës, si dhe procedurat për testimin e kontrollin përfundimtar, miratimin dhe pranimin e rrjetit të infrastrukturës, rregullat e standardet, në bazë të të cilave është projektuar projekti për ndërtimin e zonës, që duhet të jenë në përputhje me praktikat më të mira, me synim zhvillimin e tregut;

d) të drejtat dhe detyrimet e institucionit përgjegjës të zhvilluesit;

dh) sanksionet në rast mospërmbushjeje të detyrimeve;

e) të drejtat e institucionit përgjegjës ose të një autoriteti tjetër publik për të monitoruar punët që duhet të kryhen dhe shërbimet që duhet të jepen nga zhvilluesi, kushtet dhe masën, në të cilën institucioni përgjegjës mund të urdhërojë ndryshime për punët dhe kushtet e shërbimit;

ë) të drejtën e institucionit përgjegjës për të marrë masa të tjera të arsyeshme, për të siguruar që rrjeti infrastrukturor të operohet si duhet dhe shërbimet të jepen në përputhje me kërkesat e zbatueshme ligjore e kontraktuale, si dhe të drejtat për të monitoruar mekanizmat dhe trajtimin e shpenzimeve të mundshme për to;

f) detyrimet e zhvilluesit për t'i dhënë institucionit përgjegjës apo një autoriteti tjetër publik, sipas rastit, akses, raporte dhe informacion për veprimtarinë në zonë;

g) shtrirjen e detyrimeve të zhvilluesit, sipas rastit, për të siguruar ndryshimin e shërbimit, për të përmbushur kërkesat e kohës, vazhdimësinë e tij dhe dhënien, në kushte kryesisht të njëjta për të gjithë përdoruesit, mekanizmat për të trajtuar kostot e mundshme për to;

gj) detyrimet e mundshme, nëse ka, të

autoriteteve publike përkatëse ose të institucionit përgjegjës;

h) rrethanat, në të cilat institucioni përgjegjës ka të drejtën të marrë përsipër, përkohësisht, administrimin e rrjetit të infrastrukturës, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë dhe, në rastin e dështimit nga zhvilluesi, të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale, për të rregulluar shkeljen e kontratës;

i) çdo kufizim ose kusht të zbatueshëm për transferimin e të drejtave dhe të detyrimeve të zhvilluesit, sipas kontratës;

j) çdo kufizim ose kusht për transferimin e një interesi kontrollues të zhvilluesit;

k) përkufizimi dhe pasoja e forcës madhore, ndryshimi në ligj dhe ndryshime të tjera në rrethana (duke përfshirë çdo të drejtë të palëve për të kërkuar kompensimin ose rishikimin e kontratës);

l) përgjegjësinë sociale;

ll) garancitë për t'u përmbushur dhe politikat e sigurimeve dhe të të drejtave të punonjësve që duhet të ndiqen nga zhvilluesi për zbatimin e projektit;

m) procedurat e rregullimit të shkeljes së kontratës, të bëra nga njëra prej palëve;

n) kushtet dhe procedurat për ndryshimin dhe/ose përfundimin e kontratës, të drejtat dhe detyrimet e palëve, me kalimin e afatit apo përfundimin e kontratës (duke përfshirë mekanizmin e transferimit të sendeve pasurore, të teknologjisë, kompensimit, shërbimit e trajnimit dhe të mbështetjes që duhet të jepet nga zhvilluesi);

nj) ligjin e zbatueshëm dhe mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet institucionit përgjegjës dhe zhvilluesit;

o) të drejtat dhe detyrimet e palëve për informacionin konfidencial.

3. Genplani i objektit, në 6 (gjashtë) kopje origjinale, i hartuar nga eksperti topograf i licencuar dhe i konfirmuar nga bashkia nën juridiksionin e së cilës është territori që do të shpallet zona, ku të jenë përcaktuar qartë sipërfaqja e truallit gjithsej, sipërfaqja nën ndërtesë, si dhe planimetria e detajuar e objekteve në qoftë se ka, është pjesë përbërëse e kontratës. Kostot për hartimin e genplanit përballohen nga zhvilluesi.



Neni 20

Miratimi nga Këshilli i Ministrave

1. Miratimi i zhvilluesit dhe i kontratës bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Mosdhënia e këtij miratimi e bën procedurën konkurruese të pasuksesshme.

Neni 21

Ndryshimi i sipërfaqes

1. Këshilli i Ministrave brenda zonës mund të përcaktojë një sipërfaqe më të vogël, për të cilën do të kryhen procedurat e përzgjedhjes së zhvilluesit.

2. Këshilli i Ministrave mbi bazën e kërkesës së institucionit përgjegjës miraton ndryshimin e sipërfaqes së zonës, dhënë zhvilluesit.

3. Në rastet e ndryshimit të sipërfaqes, sipas pikës 2, të këtij neni, zhvilluesi duhet të paraqesë planin e investimeve, të ndryshuar, së bashku me dokumentacionin administrativ-ligjor, teknik dhe financiar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 648, datë 22.7.2015

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË
CAKTIMIT TË MENAXHERIT,
OFICERIT TË SIGURISË E
INSPEKTORIT TË AUTORIZUAR DHE
TË METODOLOGJISË SË ANALIZËS SË
RISKUT PËR SIGURINË E TUNELEVE
RRUGORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 1, 7, pika 1, 8, pika 3, e 14, pika 2, të ligjit nr. 158/2013, datë 10.10.2013, “Për sigurinë në tunelet rrugore”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtuesi teknik i subjektit juridik, përgjegjës për menaxhimin e tunelit, duhet të ketë edukimin arsimor në inxhinieri transporti ose infrastrukturë të transportit dhe të paktën 10 vjet eksperiencë në administrimin e trafikut.

Faqe | 10114

Gjithashtu, subjekti duhet të ketë personel tjetër në funksione drejtimi/administrimi, të paktën dy persona me edukim arsimor në inxhinieri mekanike ose elektrike dhe eksperiencë të paktën 5-vjeçare në zhvillimin e shfrytëzimin e operacioneve në tunele rrugore dhe procedurave të mirëmbajtjes në to.

2. Oficeri i sigurisë së tunelit rrugor dhe inspektori i autorizuar duhet të kenë edukimin arsimor në inxhinieri transporti ose të infrastrukturës së transportit, si dhe eksperiencë të paktën 5-vjeçare në sigurinë rrugore, veçanërisht në administrimin e incidenteve rrugore dhe inspektimin e sigurisë rrugore. Oficeri i sigurisë duhet të ketë njohuri edhe për sistemet inteligjente të transportit që lidhen me administrimin e incidenteve e të aksidenteve rrugore.

3. Miratimin e metodologjisë së analizës së riskut për sigurinë në tunelet rrugore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohet Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**METODOLOGJIA E ANALIZËS SË
RISKUT PËR SIGURINË NË TUNELET
RRUGORE**

KREU I**QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET****1. Qëllimi**

Analiza e riskut përcakton një strategji sigurie proaktive për të studiuar në mënyrë sistematike rreziqet potenciale. Kjo strategji zëvendëson tërësisht konceptet e bazuara në eksperiencën mbi gjetjet e incidenteve dhe aksidenteve që tashmë kanë ndodhur në tunelet rrugore.

Në mënyrë të përgjithshme analiza e riskut ka të bëjë me pasojat e mundshme negative të një sistemi teknik në të ardhmen dhe që, nuk mund të parashikohen. Opsioni i vetëm është që të zhvillohet një model realist i rreziqeve që shoqërojnë sisteme të tilla. Sikurse ekziston një numër i pafundmë i mundësive për rreziqet që mund të krijohen, është teorikisht e pamundur të



konsiderohen të gjitha këto situata, si rrjedhojë është e pashmangshme të kufizohen studimet në një numër të caktuar skenarësh. Por nga ana tjetër kjo krijon premisa për mospërzgjedhjen e skenarëve të rëndësishëm ose u vihet theksi atyre që nuk janë aq të rëndësishëm. Për këto arsye, duhet gjithnjë të kihet parasysh që, çdo analizë rrisht, cilado metodë të përdoret, është një model pak a shumë i thjeshtuar që mbështetet në kushte dhe supozime dhe nuk është kopje e realitetit.

Kuptimi i analizës së rrishtit mund të përmblihet si më poshtë:

- Analiza e rrishtit është një qasje sistematike për të analizuar sekuencat dhe ndërveprimet në incidentet dhe aksidentet e mundshme, duke identifikuar në këtë mënyrë pikat e dobëta të sistemit dhe marrjen e masave përmirësuese.

- Termi “Analizë rrishtit” mbulon një familje të madhe të qasjeve të ndryshme, metodave dhe modeleve komplekse që kombinojnë komponentë të ndryshëm metodikë për arritjen e një qëllimi të caktuar.

- Analiza e rrishtit bën caktimin sasior të rrishtit të mundshëm, dhe është një qasje me bazë performancën për vlerësimin e standardeve të sigurisë.

- Një parim i përgjithshëm bazë i të gjitha llojeve të analizës së rrishtit për tunelet rrugore duhet të jetë një qasje integrale që përfshin infrastrukturën, mjetin, operimin dhe përdoruesit.

Analiza e rrishtit mund të përdoret:

- Për të kontrolluar kryerjen e një plani të sigurisë;

- Për të zgjedhur midis alternativave ato me kosto efektive dhe siguron përdorimin optimal të burimeve financiare të kufizuara;

- Për të treguar që standardet e sigurisë janë përmbushur, për shembull në rast devijimi nga përshkrimet.

2. Përkufizime

2.1 Terma të përgjithshëm

2.1.1 Sistem: Një grup elementesh të ndërlidhura, të ndërvarura ose bashkëvepruese që formojnë një tërësi, i cili është i aftë të arrijë një objektivi të caktuar përmes ndërveprimit të pjesëve të tij.

Një sistem është normalisht i përbërë nga një nënsistem fizik, një nënsistem human dhe një nënsistem administrimi; ambienti në të cilin

sistemi është vendosur është gjithashtu i rëndësishëm.

2.1.2 Siguria: Aftësia e një sistemi për t'u rezistuar rreziqeve pa pasoja serioze.

2.1.3 Rreziku: Një gjendje e sistemit e cila është potenciale për pasoja të padëshirueshme.

2.1.4 Identifikim rreziku: Procesi i njohjes së rrishtit dhe përcaktimi i karakteristikave bazë.

2.1.5 Ngjarje: Ndodhja e një grupi të veçantë rrethanash.

2.1.6 Skenar rreziku: Një sekuencë e ngjarjeve të mundshme që krijohen nga një rrezik i caktuar dhe çojnë në pasoja të padëshirueshme.

2.1.7 Skenar: Një sekuencë e ngjarjeve të mundshme që krijohen fillestarisht nga një ngjarje e caktuar dhe shoqërohen me një sjellje të veçantë të nënsistemeve të ndryshme.

2.1.8 Probabiliteti: Një matje e mundësisë ose e shkallës së besimit të ndodhjes së një ngjarjeje të veçantë brenda një reference specifike (koha, numri i përsëritjeve etj.).

2.1.9 Probabiliteti objektivi: Probabiliteti i përcaktuar duke përdorur argumente teorike ose të dhëna të përshtatshme statistikore.

2.1.10 Probabiliteti subjektiv: probabiliteti i përcaktuar duke përdorur intuitën ose eksperiencën përkatëse.

2.1.11 Risku: Pasojat e pritshme që shoqërojnë një aktivitet. Risku mund të lidhet me ngjarje jo të favorshme për njerëzit, cilësinë e mjedisit ose vlera ekonomike.

Risku shpesh vlerësohet nga pritjet matematikore të pasojave nga një ngjarje e padëshirueshme. Si rrjedhojë vlerësohet si shumatore e produkteve "probabilitet x pasoja".

Termi risk individual përdoret shpesh për të theksuar rrishtin e një individi të veçantë sikurse termi “risk shoqëror” lidhet me rrishtin e një numri të caktuar personash.

2.1.12 Risku objektivi: Një vlerësim i rrishtit që lidhet me tërësinë e shkaktarëve të një ngjarjeje dhe e përcaktuar me argumente teorike, me të dhëna të përshtatshme statistikore (p.sh. numri i pritshëm i vdekjeve nga aksidentet rrugore) ose me metoda sasiore të analizës së rrishtit.

2.1.13 Besueshmëria: Aftësia e një strukture ose elementeve strukturore për të përmbushur kërkesat gjatë një periudhe të caktuar kohore. Besueshmëria referohet shpesh si siguri, si një gjendje pune e sigurt e sistemit.



2.2 Terma që lidhen me vlerësimin e riskut

2.2.1 Vlerësimi i riskut: Procesi i analizës së riskut.

2.2.2 Analiza e probabilitetit: Një procedurë sistematike për përshkrimin dhe llogaritjen e probabilitetit të ngjarjeve me pasoja të dëshirueshme ose të padëshirueshme.

2.2.3 Analiza shkakësore: Një procedurë sistematike për përshkrimin dhe/ose llogaritjen e probabiliteteve të shkaqeve të ngjarjeve të dëshirueshme ose të padëshirueshme.

2.2.4 Analiza e pasojës: Një procedurë sistematike për të përshkruar dhe/ose për të llogaritur pasojat.

2.2.5 Analiza e riskut: Përdorimi i informacionit që ka të bëjë me situatat e rrezikshme, probabilitetin e ngjarjeve kritike, besueshmërinë e nënsistemeve dhe analizën e skenarëve të shumtë për vlerësimin e nivelit të riskut për individët dhe popullsinë, pronën ose ambientin.

Analiza Sasiore e Riskut është një term i përdorur për të përshkruar analizën që jep informacione sasiore dhe mundëson vendimmarrjen mbi pranimin e riskut.

Analiza e riskut përfshin qëllimin, identifikimin e rrezikut dhe vlerësimin e tij.

2.2.6 Vlerësimi i riskut : Një proces që tregon vlerësimin e masave të riskut.


Vlerësimi i riskut bazohet mbi identifikimin e rrezikut dhe përgjithësisht përmban hapat vijues: përcaktimi i qëllimit, analiza e probabilitetit, analiza e pasojave dhe vendimmarrja.

2.2.7 Analiza e sensitivitetit: Një procedurë sistematike për të përshkruar dhe llogaritur efektin e variacionit të të dhënave dhe parashtruar supozime mbi rezultatin final.

2.2.8 Opsionet e analizës: Një proces i përdorur për të identifikuar një seri analizash të mundshme për menaxhimin e riskut.

Në mënyrë skematike procesi i analizës së riskut jepet në figurën 1 si më poshtë:

Figura 1



2.3 Terma që lidhen me informimin mbi riskun

2.3.1 Informimi i riskut: Shkëmbimi i informacionit mbi riskun midis vendimmarrësve dhe institucioneve të tjera përgjegjëse.

Informimi mund të lidhet me ekzistencën, natyrën, formën, probabilitetin, ashpërsinë, pranimin, trajtimin dhe aspekte të tjera të riskut.

2.3.2 Palët e interesuara: Çdo individ, grup ose organizatë që mund të ndikojë, ndikohet ose perceptohet të ndikohet nga rreziku. Vendimmarrësi gjithashtu është një palë e interesuar.

2.3.3 Perceptimi i riskut: Mënyra me të cilën një palë e interesuar sheh një rrezik, bazuar mbi një tërësi çështjesh dhe vlerash. Perceptimi i riskut varet nga nevojat e palës interesuar njohuritë dhe preferencat.

Perceptimi i riskut mund të jetë në mënyrë sinjifikative subjektiv.

2.3.4 Kriteret e riskut: Pika referimi kundrejt të cilave rezultatet e analizave të riskut vlerësohen. Kriteret bazohen në rregullore, standarde, eksperiencë dhe njohuri teorike të bazuara mbi vendime për pranimin e riskut.

2.3.5 Risk i pranueshëm: Një nivel i riskut, i cili nuk perceptohet seriozisht nga shoqëria dhe që mund të konsiderohet si pikë reference në kriteret e riskut.


Është e pritshme që aspekte të ndryshme të natyrave të ndryshme kulture, sociale, psikologjike dhe ekonomike influencojnë në perceptimin e riskut në shoqëri.

2.4 Terma që lidhen me kontrollin dhe administrimin e riskut

2.4.1 Administrimi i riskut: Procesi komplet i vlerësimit dhe kontrollit të riskut.

Një skemë e përgjithshme e administrimit të riskut paraqitet në figurën 2 si më poshtë:

Figura 2



2.4.2 Kontrolli i riskut: Veprimet që zbatojnë vendimet e administrimit të riskut.

Kontrolli i riskut mund të përfshijë monitorimin, rivlerësimin dhe përputhshmërinë me vendimet.

2.4.3 Trajtimi i riskut: Një proces selektimi dhe zbatimi masash për të modifikuar riskun.

Masat e trajtimit të riskut mund të përfshijnë shmangien, optimizmin, transferimin apo mbajtjen e riskut.

2.4.4 Administrimi i sigurisë: Një proces

sistematik i ndërmarrë nga një institucion me qëllim arritjen dhe mbajtjen e një niveli të sigurisë që përputhet me objektivat e përcaktuar.

2.4.5 Risku i tolerueshëm: Një nivel i rrezikut për të cilin një individ ose shoqëri është e gatshme të pranojë për të siguruar disa përfitime me supozimin që risku do të kontrollohet siç duhet.

2.4.6 Optimizmi i riskut: Një proces, i cili tenton të minimizojë rrjedhojat negative dhe të maksimizojë ato pozitive dhe probabilitetet e tyre respektive. Optimizmi i riskut merret me



parashikimin, mbrojtjen nga dhe zbutjen e pasojave.

2.4.7 Reduktimi i riskut: Veprimet e marra për të zvogëluar probabilitetin, pasojat negative ose të dyja së bashku.

2.4.8 Lehtësim: Kufizim i pasojave negative të ndonjë ngjarjeje.

2.4.9 Evitim i riskut: Vendimi për të mos u përfshirë ose veprimi për t'u tërhequr nga një situatë me risk.

2.4.10 Transferimi i riskut: Ndarja me një palë tjetër e humbjeve ose përfitimeve nga një risk.

Transferimi i riskut mund të bëhet përmes siguracioneve ose marrëveshjeve të tjera.

Transferimi i riskut mund të krijojë një risk të ri ose modifikojë riskun ekzistues.

Rialokimi i burimeve nuk është transferim i riskut.

2.4.11 Financimi i riskut: Alokimi i fondeve për të mbuluar kostot e zbatimit të trajtimit të riskut apo kosto të tjera.

2.4.12 Mbajtja e riskut: Pranimi i humbjeve ose përfitimeve nga një risk i veçantë.

Mbajtja e riskut përfshin pranimin e risqeve të cilat nuk janë identifikuar.

Mbajtja e riskut nuk përfshin trajtimet që kanë të bëjnë me siguracionet ose transferimin me metoda të tjera.

2.4.13 Pranimi i riskut: Vendimi për të pranuar një risk.

Pranimi i riskut varet nga kriteret e riskut.

KREU II

3. Metodologjia e analizës së riskut

3.1 Komponentët e vlerësimit të riskut

Në figurën 1 jepen hapat kryesorë të vlerësimit të riskut: analiza e riskut dhe vlerësimi i riskut. Rezultatet do të varen nga masat e marra të sigurisë. Mund të dallojmë tri etapa të vlerësimit të riskut.

1. Analiza e riskut: Analiza e riskut lidhet me çështjen kryesore: “Çfarë mund të ndodhë dhe cilat janë pasojat?”. Analiza e riskut mund të bëhet me metoda cilësore ose sasore ose në një kombinim të të dyjave. Në rastin e metodave sasore vlerësohen analiza dhe risku i probabiliteteve të aksidenteve dhe pasojat e tyre sipas treguesve (fatalitetet, plagosjet, dëmtim prone etj.).

2. Vlerësimi i riskut: Vlerësimi i riskut i përket çështjes mbi pranimin dhe diskutimin e qartë të

kritereve të sigurisë. Për një vlerësim sistematik dhe të përdorshëm të riskut duhen përcaktuar kriteret e sigurisë dhe përkufizuar nëse një nivel risku është i pranueshëm ose jo.

3. Planifikimi i masave të sigurisë: Nëse risku i vlerësuar konsiderohet si jo i pranueshëm, duhen propozuar masa shtesë të sigurisë. Si rrjedhim, efektiviteti i masave të ndryshme të sigurisë mund të përcaktohet, duke përdorur analizën e pasojave të skenarëve, të cilët do të ndikoheshin pozitivisht ose negativisht nga supozimi se masat e sigurisë do të zbatoheshin.

3.2 Komponentët e metodologjisë së analizës së riskut

Këta komponentë metodikë mund të klasifikohen në dy grupe: komponentët cilësorë, të cilët normalisht kanë një kompleksitet më të ulët se ata sasiorë dhe bazohen në standarde të përcaktuara apriori. Metodatat kualitative shpesh janë të thjeshta dhe zbatohen në mënyrë fleksibel dhe përdoren për çdo situatë, kryesisht kur mungojnë të dhënat sasore. Nga ana tjetër ekziston rreziku t'i jepet rëndësi një përshtypjeje subjektive dhe nuk merret parasysh korelacioni i elementeve të ndryshme të sistemit të analizuar.

Komponentët sasiorë përpiqen për të strukturuar ngjarjet e mundshme në mënyrë logjike dhe integrale: analizohen skenarë të ndryshëm dhe pasoja të mundshme të tyre. Një avantazh i rëndësishëm në përdorimin e metodave sasore është një prezantim transparent i rrezikut të vlerësuar, nga ku mund të kuptohen korrelacione komplekse. Nga ana tjetër ka probleme të cilat nuk mund të modelohen në mënyrë të përshtatshme (për arsye kohe dhe burimesh) sikurse dhe të dhënat e pamjaftueshme nuk mundësojnë një kuantifikim të parametrave kryesorë. Qasjet sasore janë shpesh të karakterizuara nga një shkallë e lartë kompleksiteti, të cilat nuk mund të kontrollohen më.

Qasjet e bazuara në risk mund të ndahen në dy tipa:

- Qasje me bazë skenari: Vlerësohen frekuenca dhe pasojat e një ngjarjeje dhe analizohen pasojat e tyre për një skenar të caktuar.

- Qasje me bazë sistemi: Vlerësohen vlerat e riskut për një sistem në përgjithësi. Prandaj të gjithë skenarët që ndikojnë në personat e sistemit merren në konsideratë.



Kompetët metodologjikë mund të specifikohen për të tria etapat e analizës së riskut, vlerësimi të riskut dhe planizimi i masave të sigurisë:

- Analiza e riskut: Për analizën e riskut, kombinohen komponentë të ndryshëm të metodologjisë.

- Vlerësimi i riskut: Zakonisht komponentët e metodologjisë së vlerësimi mund të kombinohen në mënyrë të kufizuar.

- Planizimi i masave të sigurisë: Zgjedhja e komponentëve të metodologjisë është e lidhur ngushtësisht me metodologjinë e vlerësimi të zbatuar.

Komponentët e ndryshëm nuk mund të kombinohen arbitrarisht. Disa komponentë të metodologjisë vlerësimi kërkojnë komponentë të caktuar të analizës.

Për qëllim të vlerësimi të riskut ka tipa të ndryshëm të kriterëve të riskut, të cilat nuk mund të zgjidhen arbitrarisht por varen nga komponentët e metodologjisë të përdorura për analizën e riskut.

Mund të adaptohen si kriterë risku:

- gjykimi i ekspertëve (subjektiv, cilësor);
- standarde përshkimore ose manuale (objektive, cilësore);

- kriterë të mbështetura në skenarë – sikurse: vlera të caktuara për mundshmëritë e skenarit, koha e largimit në një zonë të sigurt; koha e mbërritjes së shërbimeve të urgjencës (gjysmëobjektive, sasiore);

- rreziku individual – probabiliteti për t'u plagosur/vrarë në vit për personin që është i ekspozuar ndaj rrezikut (gjysmë objektiv, sasiore);

- rreziku shoqëror – vlera e pritshme; numri i pritshëm i të vrarëve në tunel çdo vit (gjysmëobjektiv, sasiore);

- parametrat me kosto – eficientë; kosto e masave të sigurisë në raport me efektet e reduktimit të rrezikut.

Kriteret sasiore, të rrezikut mund të adaptohen si vlera limite absolute (një sistem është i sigurt, nëse vlera e rrezikut të sistemit është më e ulët se vlera limit). Kriterë të tjera sasiore konsiderojnë perceptimin e rrezikut (siç janë efektet në popullsi të fatkeqësive me shumë viktime) në proceset e vlerësimi të rrezikut (p.sh. duke reduktuar rrezikun për aksidentet me pasojë).

3.3 Model, shembulli 1

Qasja metodike

Metoda bazohet në një qasje të bazuar në sistemin dhe përmban këto elemente kryesore:

- Analizë me frekuencë sasiore:

qasje analitike për analizimin e sekuencave të ngjarjeve nga momenti fillestar (aksident, defekt) me disa skenarë pasojash;

qasje statistikore për të përcaktuar numerikisht ngjarjet fillestare (aksidentet) dhe frekuencat relative (shpërndarjen).

- Analizë sasiore e pasojave:

qasje statistikore për të përcaktuar pasojat e dëmeve materiale në aksidentet e tunelit;

kombinimi i një modeli të shpërndarjes (p.sh. tymi në tunel) nëpërmjet një modeli simulimi (simulimi i vetëshpëtimit të njerëzve në tunel) për të përcaktuar pasojat e zjarrit.

Rezultatet e analizës së riskut dhe strategjia e vlerësimi të riskut

Modeli i riskut mbulon vetëm rreziqet personale të përdoruesve të rrugës

- Rezultati i analizës së riskut është vlera e pritshme e rrezikut shoqëror të tunelit të studiuar dhe pjesët respektive të riskut si pasojë e defekteve mekanike, zjarrit apo mallrave të rrezikshme tregohen më vete,

- Vlerësimi i riskut bëhet nga krahasimi relativ:

- të efekteve të reduktimit të riskut nga masat e ndryshme të sigurisë;

- të riskut të tunelit të studiuar me riskun e një tuneli referencë.

Si referim mund të përdoret një tunel me të njëjtën gjatësi, tip dhe karakteristika trafiku që përputhet plotësisht me kërkesat minimale të sigurisë që përmban direktiva evropiane. Divergjencat e identifikuara mund të vlerësohen në terma të riskut. Masat alternative për të eliminuar divergjencat mund të vlerësohen; vlerësimi i tyre mund të kompletohet nga një analizë efektiviteti kostoje.

Fusha e zbatimit të modelit

Ky model mund të përdoret për një fushë të gjerë aplikimesh, sikurse vlerësimi i sigurisë të tuneleve të reja dhe ekzistuese, mbështetje në procesin e vendimmarrjes të përzgjedhjes së masave të sigurisë në tunelet e reja, si dhe përditësimin e atyre në tunelet ekzistuese.

Një numër i madh të dhënash specifike mbi një tunel të caktuar mund të merren si të dhëna hyrëse dhe të integrohen në model.



Modeli mbulon të gjitha tipat e tuneleve rrugore me ventilim gjatësor dhe tërthor dhe të gjitha tipat e aksidenteve në tunele (mjete me defekte me shpërthim zjarri, aksidente me mjete, aksidente me mjete dhe zjarr).

Avantazhet e modelit janë:

- fleksibilitet i lartë i elementeve metodike individuale, në mënyrë që të jetë i aplikueshëm për shumicën e tuneleve, ventilimin ose konfigurimin e trafikut;

- kapaciteti që të përfshihen efektet e çdo faktori të rëndësishëm të sigurisë në mënyrë sasiore; një nga elementet kryesore është modelimi i ndërveprimit të përhapjes së tymit dhe procedurën e vetëshpëtimit në rast zjarri, i cili lejon hetimin e të gjithë faktorëve në harkun kohor të këtij procesi;

- rezultatet janë të thjeshta, qartësisht të kuptueshme dhe lehtësisht të krahasueshme.

Sidoqoftë, rezultati i modelit nuk përfshin informacionin e shpërndarjes së klasave të pasojave të aksidenteve; si rrjedhojë modeli nuk është i përshtatshëm për të studiuar specifikisht aksidentet me probabilitet shumë të ulët dhe pasoja të mëdha. Si rrjedhim, modeli nuk është i përshtatshëm për një hetim të plotë të efekteve të aksidenteve që përfshijnë mallrat e rrezikshme.

Përshtatshmëria e modelit për të plotësuar kërkesat specifike të ligjit 158/2013 “Për sigurinë në tunelet rrugore”.

Sipas shtojcës I të ligjit nr. 158/2013 "Për sigurinë në tunelet rrugore", në situata të veçanta vlerësimi i riskut bëhet për parametrat e renditur më poshtë. Duke iu referuar pikave respektive të shtojcës I, më poshtë tregohet kur kjo metodë është e përshtatshme për hetimet e nevojshme.

Pika 1.1.3. Shtojca I Vlerësimi i ndikimit të karakteristikave të veçanta të parametrave	Po, në shumicën e rasteve	Pika 2.6.2. Shtojca I Lejimi i transportit të mallrave të rrezikshme	Jo
Pika 1.2.1. Shtojca I Vlerësimi i shmangieve të kërkesave minimale të sigurisë	Po	Pika 2.9.3. Shtojca I Vendim mbi sistemin e ventilimit	Po
Pika 1.3.2. Shtojca I Vlerësimi i ndikimit të numrit të mjeteve të rënda të mallrave	Po	Pika 3.4. Shtojca I Vendim mbi vendet e shërbimit të shpëtimit	Jo
Pika 2.2.3. Shtojca I Vlerësimi i ndikimit të pjerrësisë së lartë	Po, por kjo kërkon informacion statistikor mbi ndikimin e pjerrësisë në frekuencën e aksidenteve	Pika 3.7. Shtojca I Analiza e riskut të transportit të mallrave të rrezikshme	Jo
Pika 2.2.4. Shtojca I Vlerësimi i ndikimit të korsive të ngushta të trafikut për mjetet e rënda të mallrave	Po, por kërkon informacion statistikor mbi ndikimin e gjerësisë korsisë mbi frekuencën e aksidenteve		

3.4 Model, shembulli 2

Qasja metodike

Pjesë e rëndësishme e dokumentacionit të sigurisë, duhet të jetë dhe hetimi për rreziqe të veçanta. Dokumentacioni përmban analizën e riskut në bazë të nenit 14 të ligjit nr. 158/2013 “Për sigurinë në tunelet rrugore”.

Hetimi (me qasje në bazë skenarësh) duhet të ndjekë këto drejtime:

- Përshkrim i përgjithshëm i tunelit dhe mjedisit rrethues;

- Përshkrimi funksional i tunelit;
- Identifikimi i skenarëve të rrezikut;
- Ekzaminimi i tyre;
- Përmbledhje.

Për të kryer këto studime, mund të përdoren disa instrumente. Në veçanti:

- Kryerja e një vlerësimi sasior të frekuencës së ndodhjes së ngjarjeve

- Përdorimi i një qasjeje gjysmësasiore për të renditur ngjarjet me ndihmën e një matrice frekuencë x pasoja:



	I Të vogla ose aspak	II I konsiderueshëm	III Kritike	IV Katastrofike	V Katastrofë e madhe
A Shumë shpesh					
B Shpesh					
C Rastësor					
D Rrallë					
E Shumë rrallë					
F Ekstremisht rrallë					

- Kryerja e një analize pasojash sasiore duke studiuar një sërë skenarësh, me përzgjedhje nga matrica e mësipërme duke përdorur terma standardë për zjarrit. Ky tip studimi (p.sh., përcaktim sasior i pasojave të zjarrit) përgjithësisht konsideron një kombinim të modelit për të vlerësuar tymin dhe kushtet e temperaturës në tunel dhe të modelit për të vlerësuar vetëshpëtimin e njerëzve.

Rezultatet e analizës së riskut:

- Vlerësim i përputhshmërisë të praktikës së masave të pranuar gjerësisht, të cilat përdoren në reduktimin e ndodhjes së aksidenteve;

- Për tunelet në operim që nuk janë konform ligjit nr. 159/2013, datë 10.10.2013 “Për sigurinë në tunelet rrugore”, kryhet një vlerësim i nivelit të sigurisë me synim vlerësimin e shmangieve nga standardet nëse janë të pranueshme ose nuk kanë të bëjnë me sigurinë;

- Vlerësim i përshtatshmërisë të masave të marra për të reduktuar pasojat e defekteve të pajisjeve;

- Propozime për përmirësimin e masave të marra;

Këto konkluzione u vënë rëndësi përdoruesve të rrugës dhe mundësisë së shpëtimit të tyre përmes funksionimit të pajisjeve të tunelit.

Shkalla e aplikimit të metodës

Kjo metodë përdoret në një fushë të gjerë tunelesh të ndryshme, nga ato në fazën e projektimit deri në tunele komplekse në fazën e shfrytëzimit.

Përmbledhtazi:

- Sugjeron, nëse është e nevojshme përmirësimi i kushteve për tunelin në cilëndo fazë,

- Ka, në çdo rast të dhënat bazë që administratorit të tunelit i nevojiten për të zhvilluar instruksionet e operimit dhe në bashkëpunim me shërbimet e urgjencës, planet e ndërhyrjeve të urgjencës.

Të tilla studime bëhen të kushtueshme në situata të thjeshta (tunele të shkurtra dhe me dy tuba të monitoruara mirë), sikurse dhe kjo metodë mund të mos jetë më efikasja sidomos për aksidentet që përfshijnë mallrat e rrezikshme që kanë efekte shkatërruese (eksplozivë, LPG).

Përshtatshmëria e modelit për të plotësuar kërkesat specifike të ligjit nr. 158/2013 “Për sigurinë në tunelet rrugore”.

Sipas shtojcës I të ligjit nr. 158/2013 “Për sigurinë në tunelet rrugore”, në situata të veçanta vlerësimi i riskut bëhet për parametrat e renditur më poshtë. Duke iu referuar pikave respektive të shtojcës I, më poshtë tregohet kur kjo metodë është e përshtatshme për hetimet e nevojshme.

Pika 1.1.3. Shtojca I Vlerësimi i ndikimit të karakteristikave të veçanta të parametrave	Po, në mënyrë krahasuese për disa parametra	Pika 2.6.2. Shtojca I Lejimi i transportit të mallrave të rrezikshme	Jo
Pika 1.2.1. Shtojca I Vlerësimi i shmangieve të kërkesave minimale të sigurisë	Po, veçanërisht për tunelet në shfrytëzim që do të rikonstruktohen	Pika 2.9.3. Shtojca I Vendim mbi sistemin e ventilimit	Po
Pika 1.3.2. Shtojca I Vlerësimi i ndikimit të numrit të mjeteve të rënda të mallrave	Mund të kryhen studime krahasuese, por përgjithësisht nuk hetohet	Pika 3.4. Shtojca I Vendim mbi vendet e shërbimit të shpëtimit	Po, në raste të veçanta
Pika 2.2.3. Shtojca I Vlerësimi i ndikimit të pjerrësisë lartë	Mund të kryhen studime krahasuese	Pika 3.7. Shtojca I Analiza e riskut të transportit të mallrave të rrezikshme	Jo
Pika 2.2.4. Shtojca I Vlerësimi i ndikimit të korsive të ngushta të trafikut për mjetet e rënda të mallrave	Mund të kryhen studime krahasuese		



3.5 Model, shembulli 3

Qasja metodike

Metoda bazohet në një qasje me bazë sistemi dhe analizë risku sasior. Modeli është projektuar të llogarisë riskun në një tunel me dy tuba me trafik një drejtim lëvizjeje dhe ventilim gjatësor.

Incidentet që merren në konsideratë janë: përplasjet, zjarri, shpërthimi ose rrjedhja e materialeve të rrezikshme ose toksike.

Për efekt të llogaritjeve merren 3 kategori të të vrarëve: viktimat “direkte” (të shkaktuara nga aksidentet e trafikut), viktimat për shkak të përfshirjes së mjetit nga flakët dhe viktimat nga zjarri, shpërthimet ose ekspozimet nga substancat toksike.

Rezultatet e analizës së riskut dhe strategjia e vlerësimit të riskut

Risku paraqitet si:

- Vlerë e pritshme, që është numri mesatar i të vrarëve në vit. Risku individual (risku për persona në km vit) rrjedh nga Risku i Pritshëm, gjatësia e tunelit, numri vjetor i mjeteve dhe numri mesatar i pasagjerëve për mjet.

- Risku Shoqëror (një grafik i shpeshhtësisë së ndodhjes së aksidenteve për një numër vdekjesh).

Përshtatshmëria e modelit për të plotësuar kërkesat specifike të ligjit nr. 158/2013 “Për sigurinë në tunelet rrugore”

Sipas shtojcës I të ligjit nr. 158/2013 “Për sigurinë në tunelet rrugore”, në situata të veçanta bëhet vlerësimi i riskut për parametrat e renditur më poshtë. Duke iu referuar pikave respektive të shtojcës I më poshtë, tregohet kur kjo metodë është e përshtatshme për hetimet e nevojshme.

Pika 1.1.3. Shtojca I Vlerësimi i ndikimit të karakteristikave të veçanta të parametrave	Po	Pika 2.6.2. Shtojca I Lejimi i transportit të mallrave të rrezikshme	Po
Pika 1.2.1. Shtojca I Vlerësimi i shmangjeve të kërkesave minimale të sigurisë	Po	Pika 2.9.3. Shtojca I Vendim mbi sistemin e ventilimit	Po
Pika 1.3.2. Shtojca I Vlerësimi i ndikimit të numrit të mjeteve të rënda për mallrat	Po	Pika 3.4. Shtojca I Vendim mbi vendet e shërbimit të shpëtimit	Jo
Pika 2.2.3. Shtojca I Vlerësimi i ndikimit të pjerrësisë lartë	Po	Pika 3.7. Shtojca I Analiza e riskut të transportit të mallrave të rrezikshme	Po
Pika 2.2.4. Shtojca I Vlerësimi i ndikimit të korsive të ngushta të trafikut për mjetet e rënda të mallrave	Jo		

3.6 Modeli QRAM për transportin e mallrave të rrezikshme

Modeli i njohur gjerësisht si QRAM (Quantitative Risk Assessment Model) është vlerësimi sasior i riskut dhe shërben për të vlerësuar rreziqet që paraqet transporti i mallrave të rrezikshme nëpër tunele.

Modeli është përpunuar në një program kompjuterik i cili mundëson:

- krahasimin e rreziqeve për shkak të transportit të mallrave të rrezikshme nga tuneli me ato të një rruge tjetër alternative;

- vlerësimin e çështjeve që lidhen me rregullat, p.sh., mund të përdoret për të mbështetur

vendimin e për të zgjedhur grupe kryesore të mallrave të rrezikshme për çdo tunel të caktuar;

- vlerësimin e rrezikut sipas kriterëve të pranuar për rreziqet individuale dhe shoqërore.

Produkte të këtij modeli janë hartat e skicuara të rrezikut individual përgjatë tunelit dhe rrugëve të tjera alternative dhe grafiku i rrezikut shoqëror si kurba FN ku (F - frekuenca e aksidenteve dhe N numri i të vrarëve dhe plagosurve).

Programi QRAM është bazuar në *Microsoft Excel*. Nevojitet një numër i madh të dhënash të cilat duhet të mblidhen më parë e të hidhen në program, si p.sh:

- rrugët e ndarë në seksione;



- gjeometria e tunelit (gjatësi, prerje tërthore dhe përvijimi vertikal), ventilimi, drenazhimi dhe daljet e emergjencës (sistemi i lajmërimit, hapësira e daljeve etj.);

- karakteristikat e trafikut, tipat e mjeteve dhe shpejtësitë, të përcaktuara për çdo seksion rruge dhe drejtim trafiku;

- popullsia përgjatë rrugës.

QRAM konsideron 13 skenarë aksidentesh të cilët përfaqësojnë grupet kryesore të mallrave të rrezikshme:

1. Zjarr në mjete të mallrave të rënda pa mallra të rrezikshme (20 MW);

2. Zjarr në mjete të mallrave të rënda pa mallra të rrezikshme (100 MW);

3. Shpërthime të avujve të shpërndarë nga lëndë djegëse (BLEVE) të karburanteve gaze të lëngshëm (LPG) në cilindra;

4. Zjarr në cisternat e karburanteve;

5. Shpërthim të resë së avujve (VCE) të cisternave;

6. Rrjedhja e klorinës nga cisternat;

7. BLEVE në LPG të cisternave;

8. VCE i LPG në cisterna;

9. Burim zjarri i LPG në cisterna;

10. Rrjedhje amoniaku në cisterna;

11. Rrjedhje propanoli në cilindra;

12. Rrjedhje propanoli në cisterna;

13. BLEVE i CO₂ në cisterna.

Modeli merr parasysh:

- frekuencën e aksidenteve (nga të dhënat historike)

- pasojat fizike në tunel dhe në rrugët alternative

- efektet e braktisjes dhe strehimit

- efektet e nxehtësisë dhe tymit të njerëzimit.

Rezultatet e rrugëve të ndryshme llogariten për efekt të rrezikut shoqëror. Kjo reflekton një sërë rezultatesh të aksidentit, secili me probabilitetet përkatëse. Kjo marrëdhënie ilustron me kurbën F/N; Këto kurba mund të llogariten për vlera të caktuara që përfaqësojnë numrin mesatar të aksidentuarve në vit të quajtura vlera të pritshme.

3.7 Shembuj studimorë

Shembuj studimorë mbi përdorimin e metodologjive dhe analizave të riskut në tunele mund të gjenden në publikime të ndryshme të organizmave OECD (Organizatës për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin) dhe

PIARC (Organizatës Botërore të Rrugëve).

KREU III

4. Konkluzione dhe rekomandime

4.1 Përmbledhje dhe konkluzione të përgjithshme

Zjarret me pasoja, të ndodhura në tunelet rrugore në vitet e shkuara, në vende të ndryshme evropiane tregojnë që, përdoruesit e rrugës janë më shumë të ekspozuar kur udhëtojnë në tunele se në rrugë të hapura. Në kontekstin e administrimit të sigurisë në tunelet rrugore planifikohen masa shtesë me qëllim minimizimin e rreziqeve. Përveç zbatimit të masave të sigurisë sipas manualeve dhe rregulloreve, aplikimi i qasjeve me bazë risku në procesin e administrimit të sigurisë tuneleve, ka fituar një rëndësi të veçantë.

Në këtë aspekt, ekzistojnë në një shkallë të gjerë komponentë metodologjikë sasiorë dhe cilësorë për tri elemente, siç janë: analiza e riskut, vlerësimi i riskut dhe planifikimi i masave të sigurisë. Të gjithë këta komponentë kanë avantazhet dhe dizavantazhet e tyre dhe nga kërkimet rezulton që, shumica e metodave të përdorura në praktikë janë një kombinim i tyre. Por asnjë prej tyre nuk mund të konsiderohet si më i përshtatshmi në përdorimin praktik. Si rrjedhim zgjedhja e metodologjisë duhet të bëhet duke konsideruar avantazhet/dizavantazhet në kontekstin e një situatë specifike. Duhet të kihet parasysh që metodat sasiorë (p.sh., simulime ose analiza statistikore) normalisht janë më komplekse se metodat cilësore (p.sh., gjykime ekspertësh). Për më tepër metodat sasiorë kërkojnë të dhëna specifike të cilat nuk janë të disponueshme ose jo të besueshme. Sikurse komponentët metodologjikë nuk mund të zgjidhen arbitrarisht: disa komponentë për vlerësimin e riskut kërkojnë komponentë specifike të analizës së riskut.

Mundësitë për harmonizimin e metodave të analizës së riskut për tunelet rrugore janë të kufizuara. Problemet për t'u hetuar, infrastruktura e tunelit, situata e trafikut, rregulloret dhe legjislacioni, si dhe sjellja e përdoruesve të rrugës janë aq të ndryshme sa që një metodë e vetme nuk mund të mjaftojë.

Studimi përmes metodave praktike tregon që, procesi i administrimit të sigurisë në tunelet



rrugore me bazë risku lejon një vlerësim transparent, të strukturuar dhe harmonizuar të rreziqeve për një nivel të caktuar. Për më tepër, duhet të konkludohet me masat më të mira të sigurisë në terma të minimizimit të riskut, si dhe mundësinë për të marrë parasysh kriterin e kosto përfutur. Në të gjitha vendet qasja e bazuar në riskun përdoret si një kompletim i rregulloreve dhe manualeve.

4.2 Disa rekomandime për përdorimin praktik të analizës së riskut

- Të kihet parasysh që çfarëdo metode zgjidhet, gjithnjë përdoret një model i cili është pak a shumë një thjeshtim i kushteve reale dhe nuk mund të parashihet gjithnjë zhvillimi i një ngjarjeje, por nga ana tjetër jepet mundësia që të merren vendime mbi bazë të shëndoshë dhe krahasimore.

- Kur përzgjidhet një metodë për analizën e riskut duhet të konsideroni që, mënyra e vlerësimit të rezultateve nuk është e pavarur nga e para.

- Sa herë të jetë e mundur përdorni të dhëna specifike për metodat sasiore; nëse të dhënat specifike nuk janë të disponueshme, së paku të kontrollohet origjina e të dhënave që do të përdoren (a janë kushtet në lidhje me infrastrukturën, trafikun etj. të ngjashme me situatën e analizuar?).

- Analiza e riskut duhet të kryhet nga ekspertë me eksperiencë, të cilët disponojnë informacionin e mjaftueshëm rreth metodave të përdorura.

- Rezultati i analizës sasiore të riskut duhet të interpretohet në shkallë eksponenciale dhe jo si numër preciz; modelet e riskut japin në mënyrë të paevitueshme rezultate konfuzë; vlerësimi i riskut përmes krahasimit relativ (p.sh., të masave

të ndryshme të sigurisë ose të një gjendjeje ekzistuese me një gjendje referencë tuneli) mund të zvogëlojë paqëndrueshmërinë e rezultateve.

4.3 Perspektiva dhe nevoja për hulumtime të mëtejshme

Pritet që në të ardhmen e afërt analiza e riskut të bëhet në shumë vende si një instrument për vlerësimin e riskut në tunelet rrugore. Në të njëjtën kohë eksperiencat në zbatimin e analizës së riskut dhe nevoja për një shkëmbim të eksperiencave në nivel ndërkombëtar do të rriten. Ky proces do të sjellë një përmirësim të vazhdueshëm të metodave dhe kryesisht në drejtim të:

- harmonizimit, zhvillimit të kriterëve cilësorë universale dhe të zbatueshme të analizës së riskut për tunelet rrugore dhe standardizimit të disa elementeve specifike të analizës së riskut;

- më shumë kërkime për strategjitë e mundshme të vlerësimit të riskut, duke përfshirë dhe rekomandime për zbatimin e tyre.

SHTOJCA 1

Përshkrim i detajuar i komponentëve të metodologjisë

Më poshtë do të paraqiten përmbledhtazi karakteristikat kryesore të një përzgjedhjeje më kryesore të komponentëve të metodologjisë. Komponentët janë sistemuar sipas tre shkallëve të administrimit të sigurisë: analiza e riskut, vlerësimi i riskut dhe planifikimi i masave të sigurisë.



PËRZGJEDHJE E KOMPONENTËVE TË METODOLOGJISË PËR ANALIZËN E RISKUT

Komponentët e metodologjisë	Përshkrimi	Qëllimi	Avantazhet/dizavantazhet (+/-)
Gjykimi i ekspertit	<ul style="list-style-type: none"> - Gjykimi i ekspertit është një vlerësim i ekspertëve të fushës për një çështje të caktuar. - Gjykimi i ekspertit mund të jetë i llojit cilësor dhe sasior. - Gjykimi i ekspertit mund të jetë baza për metoda të tjera. 	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i shpeshhtësisë, pasojave dhe riskut - Vlerësim krahasues i shpeshhtësisë kohëzgjatjes dhe riskut - Vlerësim i masave të sigurisë, parashikimi i kostove, parashikimi i reduktimit të mundshëm të riskut si pasojë e masave të sigurisë - I përshtatshëm për vlerësimin e nënsistemeve ose në rast të mungesës së të dhënave - Kontrolli i besueshmërisë 	<ul style="list-style-type: none"> + Jo i komplikuar - “Cilësia” e vlerësimit varet nga eksperiencia dhe njohuritë e ekspertëve - Rrezik i injorimit të disa aspekteve. - Mungon survejimi i plotë.
Metoda çfarë nëse	<ul style="list-style-type: none"> - Procedohet me pyetjen “Çfarë do të ndodhë nëse? Pyetjet e ngritura u përgjigjet një ekip i specializuar. 	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi dhe analiza e rreziqeve - Përcaktimi i masave të sigurisë - Instrument për planifikimin ose përmirësimin e sistemit - Më shumë i përshtatshëm për korrelacione të thjeshtë dhe problematik për sisteme komplekse. 	<ul style="list-style-type: none"> + Jo kompleks. + Tregimi i pikave të dobëta të një sistemi. - Cilësia e rezultateve varet direkt nga përbërja e ekipit. - Elemente të qenësishme të një sistemi nganjëherë nuk zbulohen. - Nuk përdoret për vlerësime krahasuese të sigurisë.
Procedura listë kontrolli	<ul style="list-style-type: none"> - Procedura listëkontrolli është një metodë e pastër cilësore për inspektimin e parë të një sistemi. Përdoret gjerësisht në kombinim me metoda të tjera ose si bazë për analiza të tjera. - Lista e kontrollit përmban një listë pyetjesh Një sistem analizohet mbi bazën e listë kontrollit 	<ul style="list-style-type: none"> - Analiza e sistemeve teknike dhe proceseve. - Identifikim dhe analizë e rreziqeve. - E përshtatshme për analizat rutinë/ të përsëritshme. 	<ul style="list-style-type: none"> + Jo komplekse + Përdorimi i procedurës së listëkontrollit ka avantazhin e një strukture të thjeshtë dhe mundësitë e aplikacioneve të gjëra. + Procedura e listëkontrollit jep një përshkrim paraprak të problemeve potenciale të sigurisë. - Sa më i komplikuar është sistemi i analizuar, aq më shumë komplekse bëhet procedura e kontrollit. Është e diskutueshme se si të gjitha aspektet e rëndësishme të një sistemi konsiderohen ose jo.
			<ul style="list-style-type: none"> - Problemet e reja që mund të dalin nga proceset në kombinim me rrethana të caktuara nuk identifikohen shpesh. Ngjarjet e mëvonshme pothuajse nuk konsiderohen. - Cilësia e analizës varet direkt nga kompleksiteti i listë kontrollit. Varet gjithashtu nga njohuritë e personit që e



			plotëson.
Inspektimi i sigurisë Auditi i sigurisë	<ul style="list-style-type: none"> - Qëllimi i inspektimit të sigurisë është ekzaminimi i një sistemi në lidhje me pikat e dobëta dhe rreziqet e veçanta. - Analizimi i një sistemi në diskutim me personelin operues për të identifikuar rreziqet e mundshme ose pikat e dobëta. 	<ul style="list-style-type: none"> - Analiza e pikave të dobëta - Vlerësimi i masave të sigurisë - Përmirësimi i një sistemi ekzistues pa instrumente planifikimi 	<ul style="list-style-type: none"> + Përpjekje të pakta për të arritur rezultatet e para. + Procedura është e lidhur me praktikën. - Nuk ka informacion për rëndësinë e një rreziku të caktuar ose pikave të dobëta. - Nuk aplikohet për vlerësime të krahasueshme të sigurisë.
Analiza e të dhënave statistikore Vlerësimi i të dhënave statistikore	<ul style="list-style-type: none"> - Analiza e të dhënave të mbledhura - Analiza mund të bëhet për shpeshësinë dhe pasojat. Duke pasur të dhëna të mjaftueshme, informacion mbi parametrat e shpërndarjes deviacioneve standarde mund të bëhet vlerësimi. 	<ul style="list-style-type: none"> - E përshtatshme për sisteme me karakteristikat e mëposhtme: Teknologji të mirë vendosur Të dhëna të mjaftueshme 	<ul style="list-style-type: none"> + Lidhje midis realitetit dhe modelit. - Ngjarje ekstreme nuk ndodhin shpesh gjatë periudhës së hulumtimit (të dhëna të pamjaftueshme).
	<ul style="list-style-type: none"> - Përveç të dhënave të analizës ka nevojë gjithnjë për një interpretim. 	<ul style="list-style-type: none"> - Rezultatet e analizës të dhënave statistikore shërbejnë si bazë për gjykimin e risqeve. Për më tepër, ato mund të furnizojnë me të dhëna pemët logjike. - Analiza e të dhënave statistikore janë një bazë e rëndësishme për të gjitha analizat sasiore. 	
Pemët logjike të dështimit PLD	<ul style="list-style-type: none"> - PLD përdoret për të përcaktuar funksionet logjike të komponentëve të një sistemi të cilat mund të çojnë në një ngjarje të padëshiruar. Në praktikë kjo përfshin identifikimin sistematik të gjitha kombinimeve të mundshme të dështimeve (shkaqet). - Metoda PLD është metodë deduktive. Pika e fillimit është një gjendje e caktuar e sistemit të analizuar i cili vazhdon deri në një ngjarje bazë. 	<ul style="list-style-type: none"> - PLD përdoret për sistemet e reja dhe për investigimet në rast defektesh. - PLD mund të përdoret në analizimin e të gjitha sistemeve teknike. - Analiza e shkaqeve të ngjarjeve të padëshiruara. - Përcaktimi i shpeshësisë së ngjarjeve të padëshiruara. - Identifikimi i masave të mundshme të sigurisë. 	<ul style="list-style-type: none"> + PLD lejon formulime sasiore precize. + Prezantimi grafik në një pemë logjike promovon ndërlidhjet e një sistemi të cilat nuk evidentohen lehtësisht. + PLD gjithashtu lejon analizën e ngjarjeve për të cilat nuk ka informacion të dhënash. - Për sistemet e mëdha mund të degëzohet shumë dhe të bëhet komplekse. - Për komponentë të veçantë të dhënave statistikore janë të pamjaftueshme dhe si rrjedhojë del nevoja e gjyqimit të ekspertëve.
Pema logjike: Analiza e pemës së ngjarjeve APN	<ul style="list-style-type: none"> - Në APN ngjarjet përcaktohen nga një ngjarje fillestare (ngjarjet fillestare dhe të mëvonshme). - APN ilustron ngjarjet e mundshme në sistemet e mëdha të cilat shkaktohen 	<ul style="list-style-type: none"> - APN mund të përdoret për përshkrimin dhe kuantifikimin sipas çdo lloji ngjarjeje. - Përdoret në mënyrë preferenciale për 	<ul style="list-style-type: none"> + APN lejon formulime sasiore precize + APN ilustron dhe strukturon pasojat e mundshme të një ngjarjeje. - Për sistemet e mëdha pema bëhet e paqartë.



	nga një ngjarje fillestare. Pasojat të cilat shkaktohen nga gjendja fillestare ndiqen gradualisht deri në gjendjen finale të sistemit. - Çdo ngjarje në këtë zinxhir duhet të bartë pasojat e ngjarjes së mëparshme. Duke përdorur një prezantim grafik sekuenca operationale logjike tregon se cili nga nënsistemet e një pasnjëshme dështon ose funksionon (logjika binare).	investigimin e disafunksioneve dhe incidenteve në sistemet teknike. - Analiza e pasojave të ngjarjeve. - Përcaktimi i shpeshëtisë së ngjarjeve. - Identifikimi i masave të mundshme të sigurisë.	
Pemët logjike: Analiza e shkak pasojës ASHP	- Metoda e ASHP lidh PLD dhe APN. - ASHP përdoret për përcaktimin e skenarëve të ngjarjeve.	- ASHP përdoret veçanërisht për investigimin e mosfunksionimeve dhe incidenteve në sistemet teknike.	+ ASHP zbatohet në mënyrë shumë fleksibël dhe jep një dokumentim të mirë të ngjarjeve të mundshme.
	- Defektet të cilat mund të çojnë në një ngjarje kritike analizohen duke përdorur PLD. Pasojat analizohen duke përdorur APN.		
Shtirja dhe efektet e modeleve	-Përcaktimi sasiore i pasojave të ngjarjeve, i përbërë nga disa etapa: shtrirja e analizës, analiza e ekspozimit dhe analiza e efekteve. - Duke zbatuar analizën e shtrirjes përcaktohet shtrirja e substancave të lëshuara në mjedis duke konsideruar kushtet atmosferike dhe karakteristikat mjedisore, siç janë përqendrim i ndotësve dhe efektet e nxehtësisë ose presionit. - Analiza e ekspozimit ekzaminon cilat objekte ose persona janë të rrezikuar në një situatë të caktuar. - Analiza e efekteve ekzaminon çfarë efektesh toksike, nxehtësie e presioni mund të kenë objektet e rrezikuara ose personat.	- Për analizat e detajuara, p.sh. për sistemet me rrezik të lartë potencial dhe/ose në ambiente sensitive.	+ Procedura lejon formulime të detajuara, sasiore për pasojat e një ngjarjeje. + Modele të komplikua janë të integruara kryesisht në programe të caktuara kompjuterike. - Analizat e detajuara të shtrirjes dhe efektet mund të jenë shumë të komplikua. - Përdorimi i modeleve specifike është i limituar në një fushë të vogël zbatimi. - Efektet e substancave specifike në persona janë shpesh jo të njohura. - Kalibrimi i modeleve me pasojat “reale” është shpesh problematik.
	- Pasojat të cilat mund të shkaktohen nga lëshimi i substancave të rrezikshme ose nga çlirimi i energjisë varet nga karakteristikat dhe sasia e substancave, shkalla e përhapjes dhe		



	efektet e shkaktuara nga materialet toksike ose shpërthyes. Procedura është e përshtatshme nëse efektet mbi personat dhe objektet të këtyre materialeve janë të njohura.		
Simulimet	<ul style="list-style-type: none"> - Një aktivitet simulohet dhe modelohet shumë herë. Modeli përmban në veçanti të gjitha elementet e sigurisë, të cilat mund të dështojnë me një frekuencë të caktuar. - Simulime dinamike të modeleve mund të konsiderojnë varësinë kohore dhe ndërveprimin e nënsistemeve të ndryshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> - Simulime të sistemeve dinamike (ndryshime të situatave fillestare). - Simulim aktivitetesh: p.sh., përsëritje të drejtimit të mjeteve me ngjarje të ndryshme të mundshme. 	<ul style="list-style-type: none"> + Imazhe të realitet në model + Mundësi të analizës efekteve të interferencave në sistem. - Mund të bëhet i komplikuar. Nevoja e programeve të caktuara kompjuterike - Sjellja e elementeve të sistemit duhet të jetë e njohur.

PËRZGJEDHJE E KOMPONENTËVE TË METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN E RISKUT

Komponentët e metodologjisë	Përshkrimi	Qëllimi	Avantazhet/dizavantazhet (+/-)
Gjykimi i ekspertit	<ul style="list-style-type: none"> - Gjykimi i ekspertit është një vlerësim i ekspertëve të fushës për një çështje të caktuar. - Gjykimi i ekspertit mund të jetë i llojit cilësor dhe sasior. 	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i ekspertit si një instrument për vlerësimin e riskut është i zbatueshëm për të gjitha llojet e analizave. - I përshtatshëm për një vlerësim të parë paraprak i çështjeve komplekse, si dhe për vlerësimin e çështjeve rutinë. 	<ul style="list-style-type: none"> + Përpjekje të pakta. - “Cilësia “e vlerësimit varet nga eksperiencia dhe njohuritë e ekspertëve - Rrezik i injorimit të disa aspekteve. - Pranimi i gjykimit të ekspertit për çështje komplekse është i diskutueshëm - Pa formulime të qarta të risqeve ekzistuese.
Praktikat më të mira Standarde	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i riskut bëhet duke treguar që sistemet e ekzaminuara u korrespondojnë standardeve. - Vlerësimi i riskut nuk bëhet sipas shtrirjes së riskut, por në bazë të disa masave dhe arritjes së disa karakteristikave. - Procedura shoqërohet me planifikimin e masave të sigurisë. 	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i çështjeve të fushave të subjektit. 	<ul style="list-style-type: none"> + Përpjekje të vogla në arritjen e rezultateve. - Qasje e thjeshtë dhe integrale. - Procedurat korrespondojnë me traditën ose praktikat aktuale. - Procedura nuk merr parasysh shtrirjen e riskut. - Pa formulime të qarta të risqeve ekzistuese. - Krahasueshmëri e kufizuar për probleme të tjera.
Krahasimi i shpeshësisë ose pasojave (vlera limite)	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi bëhet nga krahasimi i një sistemi të ri me atë ekzistues. 	<ul style="list-style-type: none"> - Krahasime brenda një fushe të caktuar subjekti ose fushave të krahasueshme të subjekteve. 	<ul style="list-style-type: none"> + Vlerësimi mbi bazën e krahasimeve është normalisht i thjeshtë për t'u kuptuar apo komunikuar. - Shpeshësia dhe/ose pasoja është vetëm një aspekt i veçantë i riskut - Krahasimi i sistemeve të ndryshme me mjaft skenarë nuk jepet.. - Një formulim i përgjithshëm i sistemit nuk është i mundur, sepse vlerësohen



			vetëm aspekte të veçanta.
Krahasimi i risqeve individuale (vlera limite)	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi bëhet nga krahasimi i një sistemi të ri me atë ekzistues. - Krahasimi bëhet për riskun individual të personit afektuar. Risku individual konsideron të gjithë skenarët efektet e tyre në lidhje me personin. 	<ul style="list-style-type: none"> - I përshtatshëm për riskun sasior. - Zakonisht përdoret nëse individi (disa) persona janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të larta. 	<ul style="list-style-type: none"> + Vlerësimi mbi bazën e krahasimeve është normalisht i thjeshtë për t'u kuptuar apo komunikuar. + Risku individual mbulon të gjitha rreziqet e sistemit ndaj individit. + Krahasime midis subjekteve të ndryshme të fushave është i mundshëm. - Presupozimi që risqet ekzistuese individuale janë të pranueshme nuk duhet domosdoshmërisht të quhet si korrekt. - Përshtatshmëria e masave të sigurisë nuk është e sigurt.
Krahasimi i risqeve shoqërore (vlera limite)	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi bëhet nga krahasimi i një sistemi të ri me atë ekzistues. - Krahasimi bëhet në nivelin e rrezikut shoqëror. Risqet e caktuara shoqërore të një sistemi krahasohen me një sistem referencë. 	<ul style="list-style-type: none"> - I përshtatshëm për një vlerësim risku sasior për sisteme qartësisht të krahasueshme, p.sh. zgjedhja e rrugës për transportin nga A në B. 	<ul style="list-style-type: none"> + Vlerësimi mbi bazën e krahasimeve është normalisht i thjeshtë për t'u kuptuar dhe për t'u komunikuar. + Me riskun shoqëror të të gjithë skenarëve konsiderohet e plotë piktura e rrezikshmërisë. - Krahasueshmëria e sistemeve të ndryshme nuk bëhet për shkak të madhësisë së sistemit (p.sh. distanca e rrugës) dhe karakteristikat që ndikojnë direkt në riskun shoqëror. - Përshtatshmëria e masave të sigurisë nuk është e sigurt.
Kurba FN me zonat e pranueshmërisë	<ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi i risqeve shoqërore në diagramet FN tregon, për cilat frekuenca arrihet ose tejkalohet një nivel i caktuar i pasojave të një sistemi të dhënë. - Duke caktuar një vijë pranueshmërie në diagramin FN, fiksohet gjithashtu vlera limit e riskut shoqëror. 	<ul style="list-style-type: none"> - Administrimi i riskut për transportin dhe ruajtjen e mallrave të rrezikshme. - Vlerësimi i rrezikut potencial kimik - Vlerësimi i risqeve shoqërore 	<ul style="list-style-type: none"> + Vlerësimi përmes diagrameve FN është normalisht i thjeshtë për t'u kuptuar dhe për t'u komunikuar. + Konsiderimi i përshtatshmërisë të masave të sigurisë. - Vlerësimi varet nga madhësia e sistemit. -Krahasimi i sistemeve të ndryshme është i vështirë.
Efektiviteti i kostos (kostot marginale)	<ul style="list-style-type: none"> - Risku shoqëror i një sistemi teknik mund të ulët me masa shtesë sigurie, të cilat sa më të shumta janë po aq kosto të shtuara kanë. 	<ul style="list-style-type: none"> - I përshtatshëm për qasje me bazë sistemi ku kërkohet maksimum i sigurisë dhe fondet për masa të tilla janë të limituara. 	<ul style="list-style-type: none"> + Krahasimi i sistemeve të ndryshëm është i mundshëm. + Konsiderim i alokimit optimal të fondeve. + Sigurim i përshtatshmërisë të masave të sigurisë.
	<ul style="list-style-type: none"> - Çdo masë ose kombinime të tyre karakterizohet nga një reduktim i kostove shoqërore dhe nga një kosto e caktuar. Mund të përfaqësohet me një pikë në diagramin risk kosto. - Strategjia optimale e reduktimit të riskut përbëhet nga pikat më të ulëta në diagramin risk kosto. Masat afër kubave përfaqësojnë reduktimin 		<ul style="list-style-type: none"> + Sigurimi i maksimumit të sigurisë të sistemit ekzaminuar me fonde të limituara. - Kërkon njohuri të masave të mundshme të sigurisë kostove të tyre dhe efektivitetit. - Nuk ka limite të qarta midis riskut individual dhe shoqëror.



	<p>optimal të riskut për një kosto të caktuar.</p> <p>- Parimi i efektivitetit të koston kupton që, risqet shoqërore të një sistemi mund të zvogëlohen në atë pikë të kurbës kur arrihet një kosto - efektivitet i caktuar i masave të sigurisë.</p>		
--	--	--	--

PËRZGJEDHJE E KOMPONENTËVE TË METODOLOGJISË PËR PLANIFIKIMIN E MASAVE TË SIGURISË

Komponentët e metodologjisë	Përshkrimi	Qëllimi	Avantazhet/dizavantazhet (+/-)
Gjykimi i ekspertit	<p>- Gjykimi i ekspertit është një vlerësim i ekspertëve të fushës për një çështje të caktuar.</p> <p>- Gjykimi i ekspertit mund të jetë i llojit cilësor dhe sasior.</p>	<p>- Vlerësimi i ekspertit si një instrument për vlerësimin e masave të sigurisë është i zbatueshëm për të gjitha llojet e analizave.</p> <p>- I përshtatshëm për një vlerësim të parë paraprak i çështjeve komplekse, si dhe për vlerësimin e çështjeve rutinë.</p>	<p>- Nuk janë të garantuara që masat e propozuara të jenë gjithëpërfshirëse transparente dhe të krahasueshme.</p> <p>- Jo formulime të qarta mbi efektivitetin e masave të sigurisë dhe rreziqeve ekzistuese.</p>
Praktikat më të mira standarde	<p>- Vlerësimi i riskut bëhet duke demonstruar që sistemi i ekzaminuar korrespondon me standardet.</p>	<p>- Vlerësimi i masave të sigurisë për fushat e subjektit.</p>	<p>- Formulime jo të qarta mbi efektivitetin e masave të sigurisë dhe risqet ekzistuese.</p> <p>- Moskonsiderimi i përshtatshmërisë së masave të sigurisë.</p>
Efektiviteti që lidhet me shpeshtësinë dhe pasojat	<p>- Vlerësimi i masave të sigurisë bëhet përmes konsiderimit të efektivitetit.</p> <p>- Vlerësimi i masave të sigurisë, efektivitetit të tyre që lidhet me shpeshtësinë e risqeve dhe pasojat.</p>	<p>- E zbatueshme kurdoherë, që masat e sigurisë kanë influencë në komponentët e riskut (shpeshtësi dhe pasoja).</p>	<p>+ Krahasimi i shpeshtësisë dhe pasojave.</p>
Efektiviteti në lidhje me riskun individual	<p>- Vlerësimi i masave të sigurisë bëhet duke konsideruar efektivitetin</p> <p>- Masat e sigurisë vlerësohen në lidhje me efektivitetin e riskut individual të personit të prekur</p>	<p>- Krahasimi i risqeve individuale (vlera limite)</p>	<p>- Nuk konsiderohet përshtatshmëria e masave të sigurisë që lidhen me risqet individuale</p>
Efektiviteti në lidhje me riskun shoqëror	<p>- Vlerësimi i masave të sigurisë bëhet duke konsideruar efektivitetin.</p> <p>- Masat e sigurisë vlerësohen në lidhje me efektivitetin e riskut shoqëror të një sistemi.</p>	<p>- Vlerësimi i risqeve shoqërore (vlera limite).</p>	<p>- Nuk konsiderohet përshtatshmëria e masave të sigurisë që lidhen me risqet shoqërore.</p>



Efektiviteti i kurbave FN	<ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi i risqeve shoqërore në diagramet FN tregon, për cilat frekuenca arrihet ose tejkalohet një nivel i caktuar i pasojave të një sistemi të dhënë. - Vlerësimi i masave të sigurisë bëhet duke konsideruar efektivitetin e tyre. - Masat e sigurisë vlerësohen veçanërisht për efektivitetin e tyre e lidhur me pozicionin e kurbave në diagramat FN. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kurba FN me vijat ose zonat e pranueshmërisë. 	Nuk konsiderohet përshtatshmëria e masave të sigurisë që lidhen me frekuencën dhe pasojat.
Analiza e efektivitetit të koston	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i masave të sigurisë bëhet përmes koston dhe efektivitetit të saj. - Vlerësimi i masave të sigurisë krahasohet me koston përkatëse - Preferohen masa sigurie me një shkallë kosto-efektiviteti të vogël. - Me parimin e marrëdhënies kosto efektivitet, efektiviteti i masave të sigurisë mund të konsiderohet për risqe individuale dhe shoqërore. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kostot marginale (efektiviteti koston). 	+ Efektiviteti i koston.
Diagrami e efektivitetit të koston	<ul style="list-style-type: none"> - Risku shoqëror i një sistemi teknik mund të ulët me masa shtesë sigurie. - Çdo masë sigurie ose kombinim karakterizohet nga një reduktim i caktuar i riskut shoqëror me një farë kostoje. Mund të përfaqësohet nga një pikë në diagramin risk kosto. - Parimi i efektivitetit koston përcakton që risqet shoqërore të një sistemi mund të ulen në atë pikë të grafikut të reduktimit riskut ku arrihet një efektivitet kostoje të masave të sigurisë. 	<ul style="list-style-type: none"> - I përshtatshëm për qasjet me bazë sistemi ku kërkohet siguri maksimale dhe fondet shtesë janë të limituara. 	+ Efektiviteti i koston (koston marginale).

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 393 lekë